



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“EDUKIM FIZIK DHE SPORTE”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Prof. Asc. Roland Çerepi

2. Prof. Asc. Robert Çitozi

Tetor / 2023

Për Programin e studimit Bsc në “Edukim Fizik dhe Sporte”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
2	Njësia bazë që e ofron:	“Departamenti i Edukimit Fizik e Sporteve”
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Edukim Fizik e Sporte”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Licensim: VKM Nr.150 dt. 18.04.1957
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	VKM Nr.167 dt. 28.05.1991
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMAS Nr.320, dt.24.11.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim BA Nr. 03, datë 24.01.2020
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë i Studimeve.Bachelor
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike (6 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	PAE = 16 (1 Prof.Dr, 1 Prof.Asc, 7 Dr, 7 MSc) PAK = 30 (1 Prof.Dr, 3 Dr, 26 MSc) Total = 46 Staf Akademik
18	Numri i studentëve:	85 për vitin akademik 2022-23
19	Komente / të tjera:	S'ka



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës;

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ka filluar aktivitetin e tij akademik bazuar në VKM Nr.150 dt. 18.04.1957. Me këtë Vendim të Këshillit të Ministrave ky institucion u quajt Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës. Pas zgjerimit dhe zhvillimit të tij me VKM Nr.167 dt. 28.05.1991, ky institut ngrihet në nivel Universiteti (Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”). Në vitin 2006-2007 pranë këtij institucioni, duke u bazuar në ligjin Nr. 8461 datë 25.09.1999 “Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” (ndryshuar) neni 13, me propozim të Senatit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës dhe drejtorisë së Arsimit të Lartë e të njohjes së Diplomave u miratua hapja e programit të studimit Bachelor në “**Edukimi Fizik e Sporte**” pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit gjë e cila u miratua nga Ministri i kohës, Z. Genc Pollo me Urdhër hapjeje që mban datën 27.04.2006.

Fakulteti i Shkencave të Edukimit përbëhet nga katër departamente: “Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale”, “Departamenti i Mësuesisë”, “Departamenti i Arteve” dhe “Departamenti i Edukimit Fizik e Sporteve”.

Ky program studimi i konceptuar me një filozofi moderne krijon mundësi inter-disiplinariteti brenda fushës së formimit bazë dhe synon përgatitjen e specialistëve në fushën e aktivitetit fizik dhe sporteve duke mundësuar një karrierë të mëtejshme akademike ose profesionale në mësuesi apo një nga drejtimet e fushës së sporteve.

Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të japë jo vetëm njohuri teorike, por edhe aftësi praktike. Të kombinuara së bashku këto dimensione e pajisin studentin në Bachelor me njohuri të përgjithshme dhe disa aftësi bazë në lidhje me punën apo specializimin e mëvonshëm si sportist dhe edukator sportiv.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në përmbushje të detyrimeve ligjore, ka aplikuar në ASCAL me shkresë Nr 1839/1 dt. 01.06.2022, për akreditimin e këtij programi. Aplikimi është kryer pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), në përputhje me parashikimet e Manualit: “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”, i ndryshuar. Me kryerjen e aplikimit, USH ka realizuar procesin e vlerësimit të brendshëm dhe nëpërmjet shërbimit në AMS ka nisur raportin e vlerësimit të brendshëm RVB dhe dokumentacionin mbështetës, pjesë e Dokumentacionit të Vetëvlerësimit të programit (DVV).


Raporti i vlerësimit të jashtëm është përgatitur nga një grup pune i ngritur me Urdhër të Rektoratit dhe më pas është konfirmuar po nga rektorati Nr.1420/1 dt.26.04.2023 vërtetësia e dokumentacionit të përdorur nga GVB për hartimin e RVB. Po kështu ky process është bazuar edhe në Urdhërin e ASCAL “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” Nr. 70, dt. 02.06.2023 ku theksohet se Ekspertë Vlerësimi të Jashtëm janë përzgjedhur: 1. Prof. As. Robert Çitozi; 2. Prof.As. Roland Çerepi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, (GVJ) është mbështetur në këtë proces nga koordinatori teknik i ASCAL znj. Aleksandra Xhamo.

Në punën për hartimin e Raportit, Grupi i ekspertëve të jashtëm ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 8072015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, në mënyrë të veçantë udhëzimet e ASCAL-it, si edhe ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të USH-së të vëna në dispozicion nga sistemi AMS. Ecuria e procesit të vlerësimit ka vazhduar në përputhje me axhendën e punëve të përcaktuara nga ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm zhvilloi dhe vizitën në institucion në datë 11 dhe 12 Korrik 2023 ku mori takime të rëndësishme me aktorët kryesorë të këtij programi studimi duke filluar me Dekanin e Përgjegjës të njësisë bazë, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, me pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi, me personelin administrativ, sekretarinë mësimore dhe më pas vizitoi ambientet e USH dhe ambientet ku realizohet mësimdhënia teorike e praktike për këtë program studimi. Pas vizitave në USH, grupi i punës filloi hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm në përputhje me të gjitha templates apo guidën e hartimit të tij.

Më datë 18.09.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 221/34 Prot., datë 18.09.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 22.09.2023, dhe me shkresë zyrtare Nr. 2742/1 Prot., datë 26.09.2023, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

Pasi shqyrtuam komentet e ardhura nga institucioni ne si ekspertë të jashtëm konkludojmë që institucioni është i dakortësuar me draft raportin e vlerësimit të jashtëm (DRVJ) prandaj gjykojmë që ky draft dërgohet tani nga ana jonë si Raport i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bachelor në “Edukim Fizik e Sporte” në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë

Bachelor “Edukim Fizik e Sporte”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” është institucion Publik i Arsimit të Lartë, i njohur me ligj si i tillë. Veprimtaria e tij bazohet në Nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, në Ligjin Nr. 80/2025 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në RSH”, në Statut dhe rregulloret e miratuara në zbatim të tyre. Programi i studimit BA në Edukim Fizik dhe Sporte ofrohet në pajtim me interesat kombëtare dhe synon të kultivojë tek studentët, ndër të tjera, vlerat akademike, kulturore e kombëtare, në përputhje dhe me misionin e USH-së të përcaktuar qartë në Statutin e USH-së sipas të cilit “USH ka për detyrë të ndihmojë dhe të mbështesë zhvillimin kulturor e social-ekonomik në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, duke promovuar dhe organizuar shërbime kulturore dhe formuese”. Statuti i USH, Neni 2, Pozita Juridike. Evidenca I, Neni 4 pika 5. Evidenca 1.1.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	“Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka si mision të krijojë, transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe shërbimeve si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet. Gjithashtu, USH ka si mision të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj”. Programi i studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, duke synuar përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies për të formuar specialistë të aftë, të rrisë cilësinë e kërkimit shkencor, si edhe të përmirësojë shërbimet ndaj studentëve, qëllime të cilat janë në një linjë me Rregulloren e Studimeve në FSHE-së në të cilën përcaktohet qartë se misioni i FSHE-së është “Krijimi, zhvillimi, mbrojtja dhe transmetimi i dijeve me anën e mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore si edhe formimi i specialistëve të nivelit të lartë”, me Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte, ku në Nenin 1

	<p>shprehet se “Programi i studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte ofron njohuri bazë mbi metodat e parimet shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në fushën e Edukimit Fizik”.</p> <p>Statuti i USH, Neni 4, Misioni.</p> <p>Evidenca 1.2</p> <p>Evidenca 1.3, Neni 1</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Në Strategjinë e zhvillimit të programit të studimit “Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte” 2022-26 theksohet “Në dinamikat e zhvillimeve bashkëkohore, Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte është i angazhuar që programin e studimeve të ciklit të parë ta shohë në një perspektivë të zhvillimeve të aktualitetit duke përmirësuar dhe pasuruar ofertën e studimit në këtë program. Këto ndryshime orientojnë vizionin e zhvillimit të këtij programi studimi”.</p> <p>Ai është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të 2017-2021 të Universitetit, ku, ndër të tjera, citohet: “USH ka për detyrë të japë njohuri bazë me metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet të caktuar profesioneve dhe specialitetesh, sipas fushave që mbulon, si dhe të sigurojë arsimim dhe kualifikim të mëtijshëm profesional e shkencor”, dhe ofrohet po ashtu në përputhje dhe me Strategjinë e Zhvillimit 2022-2026</p> <p>Në Rregulloren e FSHE-së Neni 5 theksohet: “Misioni i FSHE-së vjen në të njëjtën linjë me misionin e USH-së, duke synuar krijimin, zhvillimin, mbrojtjen dhe transmetimin e dijeve me anën e mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore, formimin e specialistëve të lartë dhe përgatitjen e shkencëtarëve të rinj në fushën e mësimdhënies në edukim fizik.</p> <p>Si përfundim GVJ del në përfundimin se Programi i studimit, përputhet me synimet e Njesisë kryesore asaj bazë dhe të Universitetit.</p> <p>Evidenca 1.4 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit 2022-2026.</p> <p>Evidenca IX</p> <p>Evidenca VIII</p> <p>Evidenca 1.2</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Njësia bazë, DEFS që ofron programin e studimit Bachelor në “Edukim Fizik e Sporte” është pjesë e Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe e ofron këtë program studimi që prej vitit 2006, kur pranë USH-së, u miratua hapja e programit të studimit “Edukimi Fizik e Sporte” pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</p> <p>Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte për mbarëvajtjen dhe funksionimin</p>

	<p>korrekt e mbi baza shkencore dhe bashkëkohore e këtij programi angazhon personel akademik efektiv ku përfshihen edhe pedagogë të departamenteve të tjera të USH-së, personel akademik me kontratë si edhe personel ndihmes akademik të cilët kanë përvojën dhe formimin e duhur shkencor për të ofruar programin e studimit.</p> <p>Institucioni në përgjithësi dhe Departamenti në veçanti disponojnë hapësirën e nevojshme për të ofruar një proces mësimor dinjitoz në ambientet e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, palestrën e vet për zhvillimin e orëve të praktikave sportive që janë pjesë shumë e rëndësishme e programit dhe shfrytëzon stadiumin e qytetit të Shkodrës dhe Fushën “Reshit Rusi” mbi bazën e marrëveshjes që ka USH-ja me Bashkinë e qytetit.</p> <p>Evidenca A</p> <p>Evidenca 1.5 ; 1.6 ; 1.7 ; 1.8 ; 1.9</p>			
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Bazuar në Statutin e USH Neni 9 për Njësitë kryesore theksohet “Fakulteti është njësia kryesore e USH-së që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura dhe ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme në përfundim të të cilave lëshon diplomën përkatëse. Po në Statut Neni 11, pika 2 cilësohet se Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive.</p> <p>Referuar programit të studimit bachelor në edukim fizik e sporte rezulton se emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte ofrohet në përputhje me fushën e drejtimet akademike të institucionit, klasifikimin dhe kodifikimin e programit të studimit.</p> <p>Evidenca I Neni 9, 11, pika 2</p> <p>Evidenca I neni 11, pika 2</p> <p>Evidenca 1.1</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ, konstaton se DEFS më qëllim që të ofrojë në mënyrë sa më korrekte, shkencore e bashkëkohore programin e studimit, si dhe të sigurojë mbarëvajtjen e tij vendos marrëdhënie bashkëpunimi edhe me departamentet e tjera në USH, si;</p> <p>Departamenti i Kimisë; Departamenti i Biologjisë; Departamenti i Fizikës.</p> <p>Në kuadër të këtij marrëveshjeve institucionale reciproke mes njësive kryesore, Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte përpara fillimit të vitit akademik i paraqet këtyre Departamenteve kërkesën për pedagogë, për të ofruar lëndët specifike në programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte siç janë;</p> <p>Anatomi dhe Fiziologji Hummane;</p> <p>Biologji-Biokimi e Aktivitetit Fizik e Sportit,</p> <p>Mjekësi Sportive,</p> <p>Informatikë etj.</p> <p>Gjithashtu, për të siguruar cilësinë e vazhdueshme në ofrimin e programit të studimit në departament bëhet dhe analiza e punës mësimore dhe shkencore e personelit.</p> <p>Evidenca 1.10</p> <p>Evidenca 1.11</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e GVB-së, në si GVJ, konstatojmë se për përmbushjen e objektivave mësimore e formuese të studentëve, DEFS ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme si DRAP Lezhë me synim dhe qëllim zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve në institucionet e arsimit parauniversitar, si edhe me Bashkinë Shkodër për shfrytëzimin e terreneve sportive si Stadiumin e qytetit ashtu edhe për Fushën ‘Reshit Rusi’</p> <p>USH ka disponon një sërë marrëveshjesh bilaterale me institucione homologe si Universiteti i Sporteve të Tiranës, si edhe me Universitetin “Foro Italico” në Romë.</p> <p>Aktualisht USH dhe Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, mbi bazën e marrëveshjes me Universitetin “Foro Italico” Romë janë angazhuar në projektin International Credit Mobility projekt KA171 i cili drejtohet nga Universiteti i Romës “Foro Italico” me pjesëmarrjen e Universitetit të</p>

	<p>Sporteve të Tiranës, Universitetit “Aleksander Xhuvani” Elbasan dhe Universitetit të Malit të Zi.</p> <p>U informuam gjatë vizitave në institucion që projekti është në fazën fillestare të tij dhe në këtë kuadër aktorët pjesëmarrës janë akoma në fazën e diskutimeve dhe takimeve të vazhdueshme.</p> <p>Evidenca 1.9</p> <p>Evidenca 1.12</p> <p>Evidenca 1.13</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Konstatohet që USH-ja ka një numër të madh marrëveshjesh me institucione homologe si brenda ashtu edhe jashtë vendit duke ndjekur një politikë hapje institucionale për shkëmbime eksperiencash, programesh e stafesh akademike. Ai e ka përcaktuar këtë politikë bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj në dobi të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit që ofron.</p> <p>USH-ja ka një rrjet të konsiderueshëm marëdhëniesh bashkëpunimi e partneritetesh nëpërmjet të cilëve organizon vizita studimore, praktikat profesionale të studentëve, punë vullnetare në komunitet, etj.</p> <p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve duhet të bëjë më shumë në drejtim të nënshkrimit të marrëveshjeve me IAL të huaja të cilat ofrojnë programe studimi të njëjta apo të ngjashme e cila do të mundëson funksionimin e mobiliteteve për studentët dhe stafet akademike në të ardhmen e afërt sidomos në këtë fazë ku është prioritet ndërkombëtarizimi i universiteteve shqiptare.</p> <p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me DRAP Lezhë për realizimin e praktikave profesionale në institucionet e arsimit parauniversitar, gjithashtu USH-ja ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe si Universiteti i Sporteve të Tiranës, Universitetin e Denverit, me Universitetin “Foro Italico” në Romë etj.</p> <p>Evidenca 1.9</p> <p>Evidenca 1.12</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ mësoi se çdo vit nga Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve hartohet një raport vjetor i përfitimit prej marrëveshjeve në të cilin analizohen arritjet dhe përcaktohen objektivat, përfshirë këtu edhe ato në fushën e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Raporti vjetor përmbledh dhe analizon përfitimet e këtyre marrëveshjeve.</p> <p>GVJ konstaton se USH në funksion të realizimit të praktikave sportive ka</p>

disa marrëveshje bashkëpunimi me një sërë aktorësh dhe institucionesh. Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me klube sportive, shoqata sportive, qendra rehabilitimi apo fitnesi etj.

Në gjykimin tonë ky numër i konsiderueshëm marrëveshjesh me institucione, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave sportive, krijon kushtet dhe mundësitë që këto segmente shumë të rëndësishme të formimit profesional të realizohen me cilësinë e duhur.

Nga marrëveshjet me DRAP Lezhe studentët e Departamentit të Programit të Studimit mirëprehen nga Institucionet e arsimit parauniversitar për të zhvilluar praktikat profesionale si vëzhgues.

Nga marrëveshja me Bashkinë Shkodër Departamenti shfrytëzon hapësirat e Stadiumit dhe Fushës “Reshit Rusi” për të zhvilluar orët e ushtrimeve të lëndëve specifike. Ndërsa nga marrëveshjet me institucionet homologe, stafi akademik apo edhe studentët marrin pjesë në programet exchange siç janë të parashikuara në projekt.

Raport analitik mbi perfitimet nga marreveshjet.

Evidenca 1.13

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” është i strukturuar në 3 vite shkollorë dhe 6 semestra të rregullt. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41 datë 24.1.2018, e ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E).</p> <p style="text-align: center;">A - duhen 15-20% janë faktike 35 ECTS ose 19.44% ✓ B – duhen 50-55% janë faktike 93 ECTS ose 51.67% ✓ C - duhen 12-15% janë faktike 26 ECTS ose 14.44% ✓ D - duhen 10-15% janë faktike 17 ECTS ose 9.44% ✓ E - duhen 3-5% janë faktike 9 ECTS ose 5% ✓</p> <p>Duke iu referuar kurrikulës programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” është organizuar në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Një semestër i rregullt përmban mesatarisht 30 ECTS. Bazuar në Rregulloren e organizimi të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p>Në përfundim të studimeve të tyre studentët e këtij programi grumbullojnë 180 ECTS.</p> <p>Evidenca 1.2, Kreu IV, Neni 27, pika 1, 2</p> <p>Evidenca 1.3</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” thuhet “Kjo rregullore mësimore e programit të studimit është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij”.</p> <p>Duke iu referuar përmbajtjes së Programit të studimit “Bachelor në Edukim</p>

<p>përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Fizik e Sporte” 2019-2022, dhe 2020-2023 kategorizimi i lëndëve në programin Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte mundëson pajisjen e studentëve me njohuri dhe kompetenca të domosdoshme për të qenë specialistë të aftë në fushën e edukimit fizik dhe mbështeten në bazën ligjore përkatëse.</p> <p>Si në programin e studimit 2019-2022 ashtu edhe në programin e studimit 2020-2023 lëndët janë të grupuara sipas tipeve të veprimtarive në:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Lëndë bazë për përgatitjen metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (simboli A - 35 ECTS); ➤ Lëndë karakterizuese përgatitje për disiplinën shkencore (simboli B - 93 ECTS); ➤ Lëndë ndërdisiplinore/integruese profile dhe gruplëndësh me zgjedhje (simboli C - 26 ECTS); ➤ Lëndë plotësuese, gjuhë të huaja, njohuri informatike dhe praktika profesionale (simboli D - 17 ECTS) ➤ Detyrime përmbyllëse (simboli E- 9 ECTS) <p>Evidenca 1.1</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Mbështetur në (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, "Për elementet programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", si edhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E).</p> <p>Në kategorinë A bëjnë pjesë 5 lëndë, në kategorinë B bëjnë pjesë 16 lëndë, në kategorinë C bëjnë pjesë 5 lëndë, në kategorinë D bëjnë pjesë 4 lëndë; në kategorinë E bën pjesë 1 veprimtari përmbyllëse e cila është provim përfundimtar, ose punim diplome për studentët me mesatare mbi 8.5.</p> <p>Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kategoria A - 19.44% - kategoria B – 51.67% - kategoria C – 14.44% - kategoria D – 9.44% - kategoria E – 5% <p>Bazuar në legjislacionin në fuqi shpërndarja e lëndëve është e rregullt.</p> <p>Evidenca1.1</p> <p>Evidenca2.1</p> <p>Evidenca 1.3</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në</p>	<p>Konstatohet si GVJ se në programin e studimit të Edukimit Fizik e Sporte</p>

<p>kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>është i përfshirë edhe kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit i cili është hartuar duke marrë në konsideratë bazën ligjore në fuqi.</p> <p>Sipas këtij kuadri janë parashikuar Detyrimet Përmbyllëse (Simboli E), ku veprimtaria formuese është përcaktuar provim përfundimtar me 9.0 ECTS ose 5% të totalit të ECTS-ve të programit të studimit.</p> <p>Në vitin e tretë të programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte studentët zhvillojnë lëndën e orientimit, ku në modulën orientim në mësuesi, studentët zhvillojnë praktika vëzhguese të orëve të mësimi të edukimit fizik në shkollat e qytetit të Shkodrës mbi bazën e marrëveshjes me DRAP-Lezhë</p> <p>Evidenca 1.1</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, sipas udhëzimeve të MAS. Forma e organizimit të studimeve përcaktohet gjithashtu në Rregulloren e Programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte Kreu III, Neni 6.</p> <p>Në fund të çdo viti akademik njësia bazë miraton kuotat për grupe të caktuara si shqiptarët brenda vendit, programi i dytë studimi, transferim studimesh, shtetas të huaj, me statusin e jetimi, persona me AK si dhe kategorinë romë e egjiptiane kategoritë e veçanta të studentëve, kuota që dërgohen për miratim në Senat nga Dekanati e më pas bëhet shpallja në faqen zyrtare të USH-së.</p> <p>Për tu pranuar në programin e studimit Edukim Fizik e Sporte kandidati duhet të përmbushë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të cilat hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të MAS për arsimin në fillim të vitit akademik, si dhe në maturën shtetërore.</p> <p>Në rregulloren e Programit të Studimit Kreu II, Neni 5, pika 5 janë gjithashtu të përcaktuara kriteret për pranimet në programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte ku duhet të theksohet se konkurentët për në këtë program studimi i nënshtrohen një testimi praktik bazuar në teste me bazë fizike dhe koordinative.</p> <p>Evidenca 1.3</p> <p>Evidenca 2.2</p> <p>Evidenca 2.3</p> <p>Evidenca 1.3</p>

<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të</p>	<p>U informuam gjatë vizitave në institucion, por edhe nga dokumentacioni i</p>
--	---

<p>njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>paraqitur se DEFS e cila ofron Programin e Studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte në vitin 2013 u angazhua në Projektin Tempus Speed.</p> <p>Disa nga përfitimet e këtij projekti ishin: vleresimi i kurrikulave të Shkencave të Sportit të vendeve partnere në kontekstin social-ekonomik të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe harmonizimi i kurrikulave të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Shkencat e Sportit bazuar në rezultatet e përfitimit të njohurive dhe në kompetencat e prespektivave të BE-së. Përfitimet nga angazhimi në këtë projekt janë të reflektuara në përmbajtjen e programit të studimit i cili është i ngjashëm me atë të universiteteve homologe brenda vendit. Nëse studentët kërkojnë të transferohen në një tjetër universitet, ngjashmëria e përmbajtjes së programit duhet të jetë sëpaku 70%.</p> <p>(Evidenca 2.4).</p>		
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>GVJ konstatuam se procesi i kodifikimit të programit të studimit Bachelor në Edukimi Fizik e Sporte është në proces, bazuar kjo në shkresën 295 dt 16.01.2023 (Për afatet e kodifikimit të programeve të studimit, ofruar nga Institucionet e Arsimit të Lartë) dhe vendimi nr 310 dt 11.05.2022 (Për specifikimin dhe përmbajtjen e kodifikimi të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë) e sjellë nga MAS.</p> <p>Nën orientimin e Drejtorisë së Kurrikulave, Kërkimit shkencor dhe Standardeve konstatuam se po punohet në nivel të njësisë bazë për kodifikimin e çdo programi studimi të ofruar në USH.</p> <p>Evidenca 2.5</p>		
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Konstatojmë që për momentin në USH nuk ka programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaja ndonëse në kuadër të ndërkombëtarizimit të IAL-ve në Republikën e Shqipërisë po punohet me intensitet kryesisht me universitete italiane. Programi i studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte subjekt i këtij raporti vlerësimi ofrohet nga Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte, dhe është një program kurrikulla e të cilit bën përpjekje të vazhdueshme për tu afruar me programe të ngjashme studimi brenda vendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Evidenca 2.3 ;Evidenca 1.3</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Konstatohet se mbështetur në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015 Kreu III Neni 23, FSHE-ja si njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit i përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin pasi ushtron funksionin e tij në përputhje me përcaktimet e Nenit 23.</p> <p>Gjithashtu Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte duke ju referuar ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015 Kreu III, Neni 25, konstatohet se i përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin pasi ushtron funksionin e tij në përputhje me përcaktimet e Nenit 25.</p> <p>Njësia kryesore dhe njësi bazë në kuadër të dy akreditimeve institucionale të USH-së, vendim i Bordit të Akreditimit nr.70, datë 21.09.2017 dhe vendimit të BA nr. 03, datë 24.01.2020 ka përmbushur detyrimet ligjore duke përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për veprimtarinë e FSHE, informacion për programet e studimit, raportet e analizat e punës mësimore dhe shkencore, veprimtaritë e ndryshme në kuadër të programeve të studimit, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>GVJ, konstaton se Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte që ofron programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte, ka të angazhuar një personel ndihmës akademik, i cili punon për realizimin e praktikave mësimore sportive në palestrën e Departamentit të Edukimit Fizik e Sporte për realizimin e praktikave laboratorike, në përputhje me bazën ligjore në fuqi, duke përmbushur kështu detyrimet e përcaktuara.</p> <p>Evidenca 1.5</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në strukturën e njësive bazë në USH-së është i parashikuar një koordinor për program studimi i cili e koordinon punën e tij me departamentin. Koordinatori mundet të mbulojë brenda departamentit më shumë se një program studimi të njëjtë apo të përafërt. Ai harton raport periodik vjetor mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe bisedat me stafin pedagogjik të këtij programi studimi konstatohet që ka harmoni në ndarjen e zbatimit të detyrave.</p> <p>Rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij në programin Bachelor në Edukim Fizik e Sporte e</p>

	realizon përgjegjësi i departamentit me të gjitha përgjegjësitë përkatëse. Ai përcakton pedagogët përgjegjës (tutorët) sipas kurseve e grupeve, të cilët janë pedagogët që japin mësim pranë njësisë bazë në një vit akademik. (Evidenca 2.6).			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Edukimit dhe njësia bazë Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve, zotërojnë informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”.</p> <p>Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore.</p> <p>Që nga viti 2017 funksionon platforma LMS- MOODLE, SMAK, ESSE 3, Pitagorai të cilat nënkuptojnë sisteme menaxhimi online të mësimdhënies me të gjitha funksionet e tij.</p> <p>Çdo pedagog në USH komunikon me studentët e tij me sistemin LMS- MOODLE. Nëpërmjet këtij sistemi pedagogu bën njoftime të ndryshme për klasat e tij mësimore, ngarkon silabusin, prezantimet, leksionet, materiale shtesë, vlerësimet e studentit etj.</p> <p>Të gjitha informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të Universitetit (https://uet.edu.al/bachelor/) dhe të aksesueshme nga të gjithë.</p> <p>Departamenti i Edukimit Fizik e Sporteve, pjesë e FSHE-së përgjegjës për programin e Edukimit Fizik e Sporteve disponon të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me organizimin, strukturën, si edhe përmbajtjen e programit të studimit. Anëtarët e personelit akademik kanë mundësinë të njihen me Statutin e USH, Rregulloren e studimit të USH me planin mësimor të programit të studimit si edhe syllabuset e lëndëve.</p> <p>22-XXII. Platforma esse 3.</p> <p>23-XXIII. Platforma pitagora</p> <p>24-XXIV. Platforma smak</p>

	<p>25-XXV. Platforma lms- moodle</p> <p>Evidenca I; Evidenca II; Evidenca 2.1; Evidenca 2.7</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Konstatohet se Plani mësimor në programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte ka të përcaktuara e të detajuara informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve.</p> <p>Duke ju referuar <i>Ligjit Nr. 80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”</i>, Neni 73, pikat 1, 2 si dhe aktet e tjera rezulton se programi i studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte ofrohet në përputhje me përcaktimet ligjore pasi organizohet në lëndë, module, praktike e aktivitete formuese.</p> <p>Evidenca 1.1</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Si GVJ, konstatohet se programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Kriteret e përgjithshme të pranimit janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit dhe publikohen edhe në faqen zyrtare të universitetit. Gjithashtu në Rregulloren e Studimeve Bachelor në Universitetin e Shkodrës përcaktohen qartë kriteret për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve.</p> <p>Evidenca 1.3 Kreu II, neni 5, pika 1</p> <p>Evidenca II, Kreu IV, Neni 30, pika 1,2,3</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Konstatohet se syllabuset e lëndëve të përfshira në programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte strukturohen sipas formatit që miratohet në nivel institucioni, por ato duhet të jenë konform edhe standarteve të përcaktuara nga urdhëresat më të fundit të MAS. Në fillim të semestrit përgjegjesi i departamentit miraton syllabuset të cilat janë hartuar sipas udhëzimeve specifike, dhe në to paraqiten përmbledhja dhe rezultatet e të nxënies, konceptet themelore, temat për çdo javë të veprimtarisë mësimore (leksion, seminar, ushtrime), forma e kontrollit të dijeve të si edhe literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar.</p> <p><i>Konstatohet që është e nevojshme që pas këtij akreditimi syllabet të rishikohen në mënyrë që ato të bëhen me formatin “Rezultatet e të nxënies” a-njohuritë, b-afësitë c-kompetencat. Për çdo temë mësimore duhet vendosur në krah literaturë përkatëse sepse në jo pak syllabuse ajo mund të ose është e vendosur formalisht.</i></p> <p>(Evidenca 2.7)</p>

<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Informohemi se sipas Rregullores së Programit të Studimeve, në fillim të çdo viti akademik, pra gjatë muajit shtator, titullari i çdo lënde paraqet për miratim në departament programin mësimor (me ndryshime), i cili pasi miratohet në njësinë bazë, dërgohet në Drejtorinë e Kurrikulave, Kërkimit shkencor dhe Standardeve dhe miratohen me vendim të Senatit Akademik.</p> <p>Evidenca 1.3 Kreu III, Neni 7,pika 1,2,3</p> <p>Evidenca 2.7</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	
			X	

<p>Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015, Neni 73 thuhet: “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” thuhet se: Programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.</p> <p>Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Në përfundim të programeve të ciklit të parë të studimeve lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e arsimit të kryer.</p> <p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konkludon se ngarkesa e programit të studimit është treguar në mënyrë të detajuar në programet e lëndëve. Shpërndarja e ngarkesës së punës është bërë në përputhje me ECTS përkatëse dhe respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Sipas programit të studimit shpërndarja për tre vite akademike rezulton e tillë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione; 756 orë - Seminare; 1093.5 orë - Lab/Ushtrime; 170 orë - Format e kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor = 70 orë gjithsej - Orë jashtë auditorit; 2480.5 <p>Në total për 3 vite akademike dhe 180 ECTS zhvillohen gjithsej:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - 2079.5 orë në auditor - 2480.5 orë jashtë auditorit <p>Për sa i takon orëve në auditor për programin e studimit 2020-2023 sipas planit mësimor të këtij programi, ato janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Leksione = 756 orë gjithsej -Seminare= 1129 orë gjithsej -Ushtrime= 197 orë gjithsej -Format e kontrollit të vazhdueshem dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor = 70 orë gjithsej - Në total = 2152 orë <p>Programi i studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte për nga emërtimi, përmbajtja, mundëson pajisjen e studentëve me njohuri dhe kompetenca kyçe që i shërbejnë në ushtrimin e profesionit në të ardhmen. Shpërndarja e orëve praktike dhe teorike pasurojnë përvojën e të nxënit si dhe u mundëson studentëve aplikim të drejtpërdrejtë praktik të njohurive.</p> <p>2.1 Planet mësimore për programet e studimit.</p> <p>Evidenca 1.1; Evidenca 2.1</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave realizohet mbështetur në VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021. Kategoritë mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A, B, C D dhe E.</p> <p>Lëndët e ofruara janë ndërtuar me qëllim thellimin e mëtejshëm të njohurive të studentëve dhe rritjen e aftësive të tyre për t'u punësuar pas mbarimit të ciklit të dytë të studimeve si mësues të edukimit fizik dhe sporteve por dhe në fushat e aktivitetit fizik për shëndet, fitnesit dhe rehabilitimit fizik.</p> <p>Në vitin e parë zhvillohen lëndë bazë dhe në vazhdim kalohet gradualisht në lëndë më profesionale. Konstatojmë që emërtimi i programit është në përputhje me fushën e studimit që mbulon programi.</p> <p>Evidenca 1.1; Evidenca 2.1</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit është ndërtuar në përputhje me Kartën e Bolonjës, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e pasur të stafit, dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” në USH parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore,</p>

	<p>plotësuese dhe përmbyllëse, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin e krediteve dhe lëvizshmërinë e studentëve.</p> <p>Bazuar në lëndët specifike, programi i saj paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike.</p> <p>Në dokumentin mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës theksohet se ndiqet parimi i rrahëve dhe ka një shpërndarje të tillë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 70% të programit e zënë njohuritë bazë dhe konceptet e lëndës në përputhje me objektivat e ciklit të parë. - 15% të programit e zënë njohuritë e thelluara, të aplikuara dhe krahasuese në lëndë, në përputhje me informacionin që duhet të jepet në ciklin e dytë: - 15% të programit e zënë analiza dhe kritika të teorisë dhe aplikimeve të fushës në përputhje me informacionin e ciklit të tretë: <p>Evidenca 1.1; Evidenca 2.1</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se natyra e lëndëve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në kredite siguron integritet të aspekteve teorike të informacionit që jep një lëndë dhe aplikimeve të mundshme praktike dhe mundësojnë arritjen e objektivave formuese.</p> <p>Statuti i USH-së ka material të plotë mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Proçeset dhe kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të përcaktuara në dokumentat rregullatorë të institucionit dhe të programit të studimit, në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Studentët informohen dhe orientohen në lidhje me mundësinë e transferimit të programeve të studimeve ose të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre. Për realizimin e këtij programi studimi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës së tij janë shfrytëzuar eksperiencat ndërkombëtare duke rritur kështu mundësinë e transferimit dhe mobilitetit të studentëve si dhe mundësitë për punësim pas përfundimit të studimeve apo vazhdimin e ciklit të dytë të studimeve.</p> <p>Evidenca 1.1; Evidenca 2.1</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe</p>	<p>GVJ konkludon se syllabuset e të gjitha lëndëve në këtë program studimi janë në përputhje me përcaktimet të VKM 41, dhe 185 duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënies, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga</p>

<p>ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>pedagogu.</p> <p>Gjatë shqyrtimit të syllabeve të programeve të lëndëve të programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” konstatohet se një pjesë e tyre janë të përditësuara dhe janë të bazuara në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Por, konstatohet edhe disa problematika:</p> <p><i>-Ka syllabe ku është vendosur literatura pa faqet për tematikë.</i></p> <p><i>-Ka syllabe ku 100% e literaturës është e huaj.</i></p> <p><i>Sugjerohet që syllabet pas këtij akreditimi të përditësohen me synime të qarta për përmirësimin e tyre në të ardhmen në favor të një mësimdhënie më cilësore. Mos të harrojmë se kemi autorë shqiptarë autoritete të padiskutueshme në fushën e sportit që kanë tekste universitare të shkëlqyera dhe me vlera të pakundërshtueshme.</i></p> <p><i>Harmonizimi i literaturës më bashkëkohore vendase me atë të huaj do të ishte më efektive për studentët dhe një shenjë nderimi dhe mirënjohjeje për breza të tërë profesorati që kanë vendosur kollanat e teorisë dhe praktikës sportive.</i></p> <p>Evidenca 2.7 Syllabuset pjesa 1</p> <p>Syllabuset pjesa 2.</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit Bachelor “Edukim Fizik dhe Sporte” i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master.</p> <p>Misioni i Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporte në realizimin e programit të ciklit të parë të studimit “Bachelor” në “Edukim Fizik dhe Sporte” është t’u japë studentëve një edukim cilësor, duke u bazuar jo vetëm te kërkimi shkencor, por edhe tek njohuritë praktike dhe teknike, nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, aftësisë për përdorimin e arritjeve më të mira të shkencës, si dhe forcimit të partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave.</p> <p>Si përfundim, synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe menaxheriale.</p> <p>Evidenca 1.1</p> <p>Evidenca 2.1</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor “Edukim Fizik dhe Sporte” i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i</p>

<p>studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master.</p> <p>Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> <p>Lista e Profesioneve / Mundësive për punësim të studentëve që përfundojnë studimet në Programin “Bachelor” në Edukim Fizik dhe Sporte pranë USH-së janë: institucionet parauniversitare (shkolla), qendra të fitnesit, qendra të kujdesit të peshës, palestra, organizata jofitimprurëse me projekte nga fusha e sportit, administratë qendrore dhe vendore, qendra rekreacioni, institute sporti etj.</p> <p>Evidenca VII</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Po ti referohemi Statutit të USH-së (Evidenca I, Kreu 1, Neni 11, pika 8) hartimi i Programit të Studimit përcaktohet si kompetencë e departamentit të Edukimit Fizik e Sporte dhe dërgohet për miratim në Senatin Akademik</p> <p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik është në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe përmirësohet edhe nëpërmjet konsultave me institucionet homologe.</p> <p>Gjithashtu në FSHE realizohen pyetësorë me studentët e sapodiplomuar nëpërmjet të cilëve sigurohet informacion mbi programin e studimit, si edhe është miratuar paketa e instrumenteve matës të cilësisë në USH në të cilën përmbahen pyetësorë që do të zhvillohen me studentë të sapodiplomuar, me studentë që kanë mbaruar studimet në USH si edhe pyetësorët me punëdhënësit.</p> <p>Evidenca 1.1 Evidenca 2.8 Evidenca XVI</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët</p>	<p>Po në Statutin e USH mbi të drejtat e studentit, përcaktohet edhe e drejta e</p>

<p>dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>studentëve për të shprehur vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit të USH.</p> <p>Në përbushje të kësaj të drejte themelore si edhe në funksion të përmirësimit të programit të studimit, studentët janë të përfshirë në struktura të ndryshme si në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Grupin e Vlerësimit të Brendshëm në Senatën Akademik - Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FSHE <p>Gjithashtu, në paketën e miratuar të instrumentave matës të cilësisë në USH, në funksion të përmirësimit të programit të studimit mbi bazën e përgjegjëjeve të marra, përfshihen ndër të tjerë edhe pyetësorë për studentët e diplomuar në USH.</p> <p>Evidenca I, Kreu XI, Neni 78, pika 1</p> <p>Evidenca B</p> <p>Evidenca 2.10</p> <p>Evidenca XVI</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Nëse i referohemi Strategjisë së Zhvillimit të programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte, ky program studimi është organizuar në bazë të marrëveshjes së Kartës së Bolonjës dhe legjislacionit në fuqi. Kurrikula e programit të ofruar për nivelin Bachelor është hartuar mbi bazën e literaturës shkencore dhe përvojave mësimore të Universitetit të Sporteve Tiranë, universiteteve homologe të Italisë, Athinës, Kroacisë, etj. Zhvillimi i kurrikulës është një ndër prioritetet strategjike në Strategjinë e Zhvillimit të programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte.</p> <p>Në programin e studimit të ofruar, Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte është përpjekur të përshtasë traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore, sportive dhe shkencore të vendit, si dhe të praktikojë modelet më të mira kurrikulare të vendeve fqinje dhe atyre të BE-së.</p> <p>Evidenca 1.4</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>		<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II</p>		<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	--	------------------------------------	-----------------------------------	--

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ-ja konstaton se DEFS bazuar në syllabuset e lëndëve/moduleve aplikon forma të larmishme të mësimdhënies, mësim nxënies, aftësimin profesional dhe shkencor, transmetimit të dijeve e njohurive ku mund të përmendim: leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, detyra kursit, essetë, projektet me të cilat studentët prezantohen në fillim të vitit akademik dhe janë të miratuara nga departamenti.</p> <p>Në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte 2019-2022 orët në auditor janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione = 746 orë gjithsej - Seminare = 1093.5 orë gjithsej - Ushtrime = 170 orë gjithsej <p>-Format e kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor = 70 orë gjithsej.</p> <p>- Në total = 2079.5 orë.</p> <p>Për sa i takon orëve në auditor për programin e studimit 2020-2023 sipas planit mësimor të këtij programi, ato janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Leksione = 756 orë gjithsej -Seminare = 1129 orë gjithsej -Ushtrime = 197 orë gjithsej <p>-Format e kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor = 70 orë gjithsej</p> <p>- Në total = 2152 orë</p> <p>Evidenca 2.7</p> <p>Evidenca 3.1</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Duke iu referuar rregullores së programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte ku është e theksuar që programet e studimit dhe puna akademike ka në fokus studentin, kërkesat e tyre duke synuar formimin e tyre shkencor dhe profesional për të qenë nesër misionarë të dijes kudo që të punojnë.</p> <p>Format kryesore të mësimin janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, essetë, punet praktike, punimet vjetore, projektet e kursit, ekspeditat mësimore, kontrollet me shkrim e

	<p>detyrat e kursit, provimet e kursit, mbrojtja e tezës së diplomës, gjë e cila reflektohet edhe në syllabuset e lëndëve të programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte.</p> <p>Evidenca 1.3, Neni 10, pika 1 Evidenca 2.7 Evidenca 3.1</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Vlerësojmë se USH e mbështet stafin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike nëpërmjet leksioneve të hapura, programeve të shkëmbimit që zhvillohen në kuadër të projekteve të ndryshme me qëllim trajnimin lidhur me mësimdhënien apo kërkimin shkencor, apo edhe ditëve të hapura virtuale të cilat mundësojnë shkëmbin e eksperiencave në mënyrë virtuale por gjithashtu krijojnë mundësi për bashkëpunime të reja.</p> <p>Në Universitet organizohen gjithashtu takime informuese në lidhje me programet kombëtare dhe ndërkombëtare për projektet e kërkimit shkencor, mobilitetin, infrastrukturën kërkimore shkencore.</p> <p>Të gjitha njoftimet, veprimtaritë apo projektet e ndryshme postohen edhe në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës.</p> <p><i>Sugjerojmë që njësia bazë e cila mbulon këtë program studimi mundet të jetë më aktive duke qenë ajo organizatore apo bashkëorganizatore e ëorkshop-eve të ndryshme apo konferencave në nivel universiteti dhe më gjërë pse jo me përfshirjen edhe të studentëve ekselentë.</i></p> <p>Evidenca 3.2 Evidenca 3.3</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Universiteti i Shkodrës bazuar në dokumentacionin e plotë i cili na është vënë në dispozicion është i qartë në objektivat dhe në strategjitë institucionale të mësimdhënies dhe punon vazhdimisht për përditësimin dhe modernizimin e tyre.</p> <p>Strategjia e mësimdhënies i ka të mirëpërcaktuara qëllimet e veta strategjike në lidhje me mësimdhënien. Për të realizuar këto qëllime USH-ja bazohet në disa parime teorike dhe aspekte praktike që kanë të bëjnë më aktivizimin e metodave të ndryshme të cilat sigurojnë mësimdhënie cilësore dhe bashkëkohore si edhe përdorimin e teknikave aktive të cilat nënkuptojnë pjesëmarrje aktive dhe të ndërgjegjshme të studentit.</p> <p>Në CV-të e personelit akademik si efektiv, po ashtu edhe të personelit akademik me kohë të pjesshme, por edhe gradat e titujt që ky personel disponon vërtetojnë se personel akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit është kompetent në shpjegimin e koncepteve dhe njohurive.</p> <p>Format e larmishme të mësimin që përcaktohen në rregulloren e programit të</p>

	<p>studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte, por edhe në syllabuset e programit të studimit dëshmojnë se stafi akademik nxit mendimin krijues dhe kritik tek studenti, njëkohësisht luajnë rolin e tyre si udhëheqës dhe mbështesin ndërtimin e marrëdhënieve reciproke dhe janë në përputhje të plotë me Strategjinë e Mësimdhënies së USH.</p> <p><i>Nga shqyrtimi i CV-ve dhe i ngarkesës mësimore vjetore për secilin personel akademik, GVJ, ka disa rezerva mbi disa lëndë/module të cilat jepen nga stafe akademike që nuk e kanë formimin e përgjithshëm dhe të thelluar për të qenë titullarë të këtyre lëndëve apo moduleve.</i></p> <p>Evidenca IV</p> <p>Evidenca 1.5</p> <p>Evidenca 1.6</p> <p>Evidenca 1.3, Neni 10, pika 1</p> <p>Evidenca 2.7</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Njësia bazë në bashkëpunim me dekanatin dhe stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm, bën përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies, duke u bazuar në mendimet, opinionet dhe vlerësimet që merren drejtpërdrejtë nga ndërveprimi me studentët dhe këto sugjerime për ndryshim dhe përmirësim reflektohen në syllabuset e lëndëve/moduleve.</p> <p>Vlerësimi i formave dhe i metodave të mësimdhënies bëhet edhe nëpërmjet pyetësorëve të studentëve. Një pyetësor i tillë është hartuar nga Dekanati bazuar mbi Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, dhe shpërndahet nga NJSBC-ja (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë) e FSHE-së. Relacioni me përgjigjet e pyetësorit miratohet nga Dekanati dhe u shpërndahet departamenteve të cilët reflektojnë mbi përgjigjet e marra nga studentët.</p> <p><i>GVJ, pasi u njoh me pyetësorin e studentëve është e mendimit që ky pyetësor duhet të guxojë edhe për të kërkuar jo vetëm elemente të cilësisë së mësimdhënies, por edhe tek elementet korruptivë apo të mitmarrjes. Kjo mundësi u duhet krijuar studentëve në mënyrë që zëri i tyre të jetë thirrje për ndershmëri e pastërti akademike e morale. Konstatohet që pjesëmarrja e studentëve të këtij programi studimi në pyetësor ka qenë e ulët ndaj duhet synuar një pjesëmarrje më e plotë e tyre.</i></p> <p>2.8 Pyetësori me studentët e sapo diplomuar.</p> <p>Evidenca 2.10; Evidenca 3.4; Evidenca 3.5; Evidenca 3.6</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel</p>	<p>USH-ja si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel universiteti organizon</p>

<p>institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>në mënyrë të vazhduar dhe periodike struktura në nivel institucional që kontribuojnë dhe promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.</p> <p>Një strukturë e tillë të cilën e kërkon edhe Ligji 80/2015 i arsimit të lartë është edhe NJSBC-ja e FSHE-së e cila koordinon dhe bashkërendon me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies sikundër është përcaktuar edhe në Manualin e Cilësisë së USH-së.</p> <p>Synohet jo vetëm rritja e cilësisë së mësimdhënies duke monitoruar cilësinë e mësimdhënies të stafit akademik aktual, por edhe duke trajnuar personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p> <p>Universiteti i Shkodrës organizon aktivitete trajnimi në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Këto aktivitete synojnë trajnimin dhe njohjen e stafit akademik në aplikimin e metodave të ndryshme innovative në fushën e mësimdhënies.</p> <p>Një aktivitet i tillë psh, është aktiviteti i organizuar nga Laboratori i Trainimeve të Edukimit të Vazhduar në Fakultetin e Shkencave të Edukimit “Flipped Classroom”.</p> <p>Gjithashtu gjatë periudhës së pandemisë, USH, për të ardhur në ndihmë si pedagogëve ashtu edhe studentëve gjatë zhvillimit të mësimin online, hartoi rregulloren e mësimin online dhe udhëzues përdorimi të platformës Microsoft Teams, si një formë e re dhe inovative e mësimdhënies.</p> <p>Evidenca 2.10; Evidenca 3.8; Evidenca 3.7</p> <p>Evidenca X; Evidenca XX; Evidenca XXI</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe</p>	<p>Universiteti i Shkodrës në zbatim edhe të ligjit dhe udhëzimeve të MAS ka hartuar dokumenta rregullatore që përcaktojnë kriteret dhe mënyrat e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe bëhen publike për studentët nga pedagogët dhe nga pedagogët e secilës lëndë/modul në fillim të çdo lënde.</p>

<p>njihen nga studentët.</p>	<p>Këto dokumenta janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja e Studimeve në USH. - Rregullorja e programit të studimit. <p>Gjithashtu, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara edhe në syllabuset e lëndëve dhe pedagogët informojnë studentët në lidhje me to që në fillim të vitit akademik.</p> <p>Pjesëmarrja në leksione dhe seminare vlerësohet 10%</p> <p>Rrezultatet e arritura në testet e seminareve teorike 20%</p> <p>Rrezultatet e arritura në provimin përfundimtar 70%</p> <p>Evidenca II, Kreu IV, Neni 22, 23, 24, 25, 26</p> <p>Evidenca 1.3, Kreu IV, Neni 13, 14, 15, 16, 17</p> <p>Evidenca 2.7</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në javën e parë të fillimit të çdo lënde/moduli, pedagogu informon studentët mbi programin lëndor, i cili përmban informacion mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përmbajtjen e lëndës të organizuar në javë, - objektivat e lëndës, - rezultatet e të nxënit të lëndës, - literaturën bazë dhe të rekomanduar dhe - materialet e tjera të lëndës, - metodën e vlerësimit të lëndës, - shpërndarjen e ngarkesës së bashku me afatet për secilin detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. <p>Vlerësimi i lëndës përcaktohet apo është në varësi të tipologjisë së lëndës. Njoftime për provimet dhe vlerësimet vendosen edhe në platformën LMS-Moodle. Kontakte të vazhdueshme me email me studentët mban edhe koordinatori i programit të studimit.</p> <p>Përgjatë vizitës në institucion dhe gjatë intervistave me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi lehtësitë e marrjes së informacionit nga ana e studentëve.</p> <p>Evidenca 2.7</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Bazuar në syllabuset e lëndëve testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, që janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - seminareve, - provimeve sezonale, - punimeve të temave të ndryshme shkencore,

	<ul style="list-style-type: none"> - esse - projekte shkencore <p>Këto forma të larmishme u japin mundësi studentëve të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara sipas përcaktimeve të bëra në lidhje me sistemin e vlerësimit në Rregulloren e studimeve në USH si edhe në Rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Evidenca 2.7</p> <p>Evidenca II, Kreu IV, Neni 22, 23, 24, 25, 26</p> <p>Evidenca 1.3, Kreu IV, Neni 13, 14, 15, 16, 17</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Njësia bazë bashkë me stafin akademik vlerësojnë dhe përmirësojnë vazhdimisht format e metodat e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme duke përfshirë edhe studentët në këtë proces nëpërmjet pyetësorëve që zbaton NJSBC-ja.</p> <p>Mendimet dhe sygjërimet e dhëna nga studentët janë objekt diskutimi në departament dhe mbi to reflektohet mbi format dhe metodat e mësimdhënies si edhe mbi mënyrat e vlerësimit të njohurive.</p> <p>Evidenca 2.10</p> <p>Evidenca 3.4</p> <p>Evidenca 3.5</p> <p>Evidenca 3.6</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nëse i referohemi Strategjisë së Zhillimit të USH-së 2017-2021, konstatojmë se mësimdhënia është një ndër prioritetet mbi të cilat mbështetet zhvillimi i USH-së dhe ka në thelb përdorimin e metodave të ndryshme të cilat sigurojnë mësimdhënie bashkëkohore dhe cilësore.</p> <p>Ky prioritet mbështetet në dy parime, në implemetimin e metodave të reja dhe të konsoliduara mësimdhënieje, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues, kërkesat e punëdhënësve dhe në funksion të përmirësimit të të nxënësve, si edhe nga përdorimi i teknikave aktive të cilat nënkuptojnë pjesëmarrje të ndërgjegjshme të studentit.</p> <p>Gjithashtu, rritja e cilësisë si edhe përsosmëria në mësimdhënie dhe në kërkim janë përcaktuar si dy prioritet kryesorë mbi të cilat mbështetet Strategjia për Zhvillim e USH-së për periudhën 2022-2026.</p> <p>Referuar syllabuseve të lëndëve mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte ofrohet në forma dhe metoda të larmishme, pasi lidhen direkt me formimin e përgjithshëm të studentëve si specialistë të ardhshëm në fushën edukimit fizik, si trainerë, si instruktorë</p>

	<p>fitnesi etj.</p> <p>Format e larmishme të mësimdhënies këtë program studimi inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë komunikim real dhe mbështetjen nga mësimdhënësi, por njëkohësisht ndërtojnë marrëdhënie respekti reciprok mes tyre.</p> <p>Evidenca IX</p> <p>Evidenca VIII</p> <p>Evidenca 2.6</p> <p>Evidenca 3.1</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi i një lënde apo nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtme: a. Provimi i ndërmjetëm b. Niveli i diskutimit në seminare c. Detyra e kursit (ese, prezantime, projekte) dy detyra praktike d. Provimi përfundimtar. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa elementeve, në varësi të tipologjisë së lëndës.</p> <p>Shkalla e përvetësimit të dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 1 deri 10), me pikë ose me përqindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS nga shkronja A deri në F). Vlerësimi me notë është i detyrueshëm. Nota kaluese konsiderohen nga 5 e lart dhe shkronjat nga A deri F.</p> <p>Referuar syllabuseve të lëndëve/moduleve testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> <p>Vlerësimi i studentit, bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte, është i përcaktuar të bëhet mbi bazën e vlerësimit të vazhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuara në programin e disiplinës/modulit dhe vlerësimi me provim. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për lëndët /modulet e cilësuara provim në planin mësimor përfaqëson 30%-40 % të vlerësimit përfundimtar.</p> <p>Në Rregulloren e Programit të Studimit janë të përcaktuara gjithashtu</p>

	<p>detyrimet që duhet të shlyejë studenti në programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte për lëndët “Provim” në të cilat studenti vlerësohet me provim. Studentët njihen me format e kontrollit të dijeve nga pedagogu i lëndës që në prezantimin e tyre të parë.</p> <p>Evidenca 2.7 Evidenca 1.3, Kreu IV, Neni 13, pika 4 Evidenca 1.3, Neni 14, 15 Evidenca 3.9 Evidenca 2.7</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Nga vizita në institucion konstatojmë që, në përgjithësi, provimet janë në formatin e provimeve të bazuara në letër, zhvillohen dhe vlerësohen në mënyrë anonime. Detyrat, projektet, dorëzohen në mënyrë elektronike dhe/ose të printuar tek pedagogu përkatës. Në të dy rastet, sekretaria hedh notat në regjistrin përkatës elektronik.</p> <p>Studenti fiton të drejtën e dhënies së provimit të një lënde kur ka qenë i pranishëm në masën e detyrueshme në leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat sipas përcaktimeve edhe në Rregulloren për funksionimin e Sekretarisë Mësimore.</p> <p>Në projektet për të ardhmen në USH parashikohet të zgjerohet zbatimi i testimit online krahas proceseve të tjera të mësimdhënies.</p> <p>USH e konsideron përfshirjen e teknologjisë në vlerësimin e performancës së studentëve si një mjet të vlefshëm për rritjen e transparencës, saktësisë dhe sigurimin e cilësisë në vlerësimin e studentëve. Për këtë qëllim USH ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Albanian-American Development Foundation për zbatimin e projektit Clean-Score.</p> <p><i>GVJ sugjeron që USH si pjesë e programit CleanScore dhe veçanërisht ky program studimi duhet të kalojë drejt korrigjimit 100% të testeve elektronikisht gjë e cila jep dy mundësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - korrigjimin në kohë rekord dhe pa kontestime. - ul në minimum subjektivizmin në vlerësimin e studentit me notë. <p><i>Është shumë e rëndësishme në këtë proces që stafi akademik të trajnohet për mënyrën e hartimit të pyetjeve, nivelit të vështirësisë etj.</i></p> <p>(Evidenca XXII) (Evidenca 3.10)</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Konstatojmë se vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p> <p>Titullari i lëndës përfshin në testim çështje kryesore të trajtuara në leksione dhe seminare, por është shumë e rëndësishme që pyetjet e tezës mos të lidhen vetëm me leksionet, por edhe me literaturën bazë dhe të rekomanduar të cilat janë pjesë integrale e formimit dhe kontrollit të dijës së studentëve gjatë të</p>

	gjithë vitit akademik. Evidenca 3.11
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<p>Vlerësimi i kompetencave dhe aftësive të studentit, përveç vlerësimit me pikë/notë, shoqërohet me komente, veçanërisht në detyra kursi, projekte, prezantime dhe forma të tjera të ngjashme vlerësimi ku evidentohen pikat e forta dhe të dobëta dhe jepen rekomandimet përkatëse sesi ato mundet të përmirësohen.</p> <p>Gjatë takimit që patëm me studentët e programit u vu re perceptimi pozitiv nga ana e tyre mbi komentet, këshillat dhe rekomandimet e pedagogeve si mundësi konkrete që ndihmojnë studentët të përmirësohen në të ardhmen. Pedagogu në tezën e provimit ka edhe seksionin e komenteve për pyetjet me alternativa.</p> <p>Për zhvillimin e testit përfundimtar zhvillohet paraprakisht një seancë sqaruese me studentët, bëhet përmbledhje e temave dhe koncepteve kryesore të trajtuara dhe bëhet shpjegimi i kriterëve të vlerësimit.</p> <p>Sipas Rregullores së USH-së 2019, në përfundim të korrigjimit të provimeve pasi bëhet sekretimi, studentët njihen me rezultatet 7 ditë pas zhvillimit të provimeve nëpërmjet postës së tij elektronike osë në një takim sqarues në një datë e cila i bëhet e njohur edhe drejtorit të departamentit.</p> <p>Pas takimit sqarues pedagogu plotëson notat në sistem dhe gjeneron procesverbalin.</p> <p>Evidenca II Neni 30, pika 4, Dosja I</p> <p>Evidenca 3.12</p>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	<p>USH, nëpërmjet rregullores mbi disiplinën e studentëve, merr të gjitha masat që sallat e provimeve të jenë të monitoruara, pa praninë e celularëve dhe të librave apo evidencave studentore në tavolinën e provimit si dhe dënon kopjen dhe plagjiaturën.</p> <p>Rastet e dyshuara për kopje ose plagjiaturë trajtohen përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Përveç rregullores së shkruar, universiteti përdor mekanizma që kontrollojnë plagjiaturën për detyrat me shkrim e sidomos temat e diplomave si detyrime përmbyllëse.</p> <p>Plagjiatura dhe kopjimi ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese gjatë vitit. Nëse kopjimi apo plagjiatura përsëritet 3 herë studenti përjashtohet nga universiteti.</p> <p>Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte është e qartë se për të siguruar zhvillimin korrekt të provimit lëndës/modulit provimi mbikqyret nga anëtarët e komisionit.</p>

	<p>Gjithashtu masat për studentët që konstatohen duke kopjuar, janë parashikuar në Nenin 33, pika 1,2 e Rregullores së Studimeve në USH si edhe në nenin 24 të Rregullores së Programit të Studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte ku theksohet se studenti që kapet duke kopjuar gjatë provimit, ndërpret provimin, e vlerësohet mbetës në atë lëndë.</p> <p>Sugjerojmë që USH-ja të implementojë sistemin anti plagjiaturë (Turnitin Ephorus), i cili mundëson kontrollin dhe vlerësimin e pastërtisë dhe origjinalitetit të çdo punimi përpara vlerësimit përfundimtar. Kjo gjë do të vlente si për studentët por edhe më shumë për stafet akademike.</p> <p>Evidenca 1.3, Neni 21, pika 10 Evidenca 3.13 Evidenca II Evidenca 1.3, neni 24</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se në dokumentacionin dhe evidencat e shqyrtuara afatet e përfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura në kalendarin akademik të universitetit. Tezat e provimit formulohen nga titullari i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i lëndës përpara shumëfishimit për provim.</p> <p>Finalizimi i notave realizohet me anë të sistemit elektronik, pas periudhës së provimit përfundimtar. Vlerësimi i studentit bëhet në bazë të meritës.</p> <p>Dosja e provimit është e plotë në përmbajtje, duke përfshirë fletët e provimit, fletë-përgjigje, një kopje të pikëve të provimit përfundimtar dhe dy kopje të notave përfundimtare.</p> <p>Sipas Rregullores së USH-së 2019, në përfundim të korigjimit të provimeve pasi bëhet sekretimi i tyre, studentët njihen me rezultatet 7 ditë pas zhvillimi të provimeve nëpërmjet postës së tij elektronike osë në një takim sqarues në një datë e cila i bëhet e njohur edhe përgjegjësit të departamentit. Pas takimit sqarues pedagogu plotëson notat në sistem dhe gjeneron procesverbalin.</p> <p>Evidenca II Neni 30, pika 4 Evidenca 3.12</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit si dhe nga vizita ne universitet u konstatua se studentët e ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u njohur me vlerësimin si dhe për të kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi duke paraqitur një ankese në sekretarinë mësimore me anë të një formulari të veçantë, menjëherë pas shpalljes së notave përfundimtare, por para shënimit të notës në regjistrin e arritjeve akademike.</p> <p>Studenti informohet në kohë reale për rezultatet e vlerësimit, përmes sistemit online Pitagora. Pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankese ose</p>

<p>e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin.</p> <p>Pas sqarimit dhe konkludimit dypalësh student - pedagogu i lëndës, ky i fundit plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore.</p> <p>Mbi bazën e Rregullores së Studimit në USH-së 2019 në nenin 30, pika 4, në rastin kur studentët nuk janë dakord me vlerësimin e bërë, në ditën e marrjes së rezultatit, mund të paraqesin kërkesë me shkrim tek Dekani i fakultetit për rivlerësim, kërkesë e cila i dërgohet departamentit përkatës.</p> <p>Departamenti pasi shqyrton kërkesën, krijon një komision ad-hoc për rivlerësimin e studentit dhe vë në dijeni pedagogun e lëndës.</p> <p>Në RVB theksohet “Në departamentin e Edukimit Fizik e Sporte nuk rezulton të jetë e depozituar ndonjë ankimim apo kërkesë për rishikim të vlerësimit nga studentët”.</p> <p><i>Urojmë dhe besojmë në vlerësime të pakontestueshme nga ana e stafit akademik të programit të studimit, por nëse do kishte ankimime do e lexonim si shenjë integriteti dhe lirie shprehje nga ana e studentëve.</i></p> <p>Evidenca II</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.4 Institucioni ngrë struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Nëse i referohemi Statutit të USH-së thuhet se: USH harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. NJSBC është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të USH.</p> <p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është strukturë autonome, e përhershme. Ai vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme mbështetur në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hapësirën Europiane të sigurimit të cilësisë - Legjislacionin në fuqi. <p>Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, ai organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.</p> <p>Bazuar në planin mësimor si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në</p>

	<p>përfundimin se programi i studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte që ofrohet nga Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte, siguron formimin e shprehive të veçanta, thellimin e njohurive, zhvillimin e kompetencave dhe aftësive profesionale të studentëve, si edhe u garanton të diplomuarve në këtë program studimi njohuritë e nevojshme për vijueshmërinë e karrierës së tyre akademike.</p> <p>Evidenca 2.1 Evidenca 2.7 Evidenca 1.1</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Konstatohet se programi i studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe gjuhën e huaj) përmes lëndëve që ajo ofron, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - SPSS, - Anatomi dhe Fiziologji humane - Sociologji dhe Psikologji sportive, - Gjuhë Angleze, - Gjuhë Italiane etj. <p>Sigurisht që edhe laboratorit i teknologjisë së informacionit është një ndihmë e madhe në këtë drejtim sidomos për studentët që do të përballen me sfidat e teknologjisë në çdo hap të jetës së tyre profesionale dhe jo vetëm.</p> <p>Evidenca 1.1 Evidenca 2.7</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Studentët e programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte njihen me përmbajtjen e syllabuseve të secilës lëndë/modul si edhe kompetencat dhe aftësitë që duhet të fitojnë ata në çdo lëndë /modul të programit të studimit që në prezantimet e para me pedagogët e secilës lëndë.</p> <p>Gjithashtu personeli akademik evidenton çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p> <p><i>GVJ e ka theksuar edhe më lart që kompetencat duhet të shprehen më qartë dhe në forma më të koncentruara në syllabet e lëndëve/moduleve.</i></p> <p>Evidenca 2.7</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet</p>	<p>Është e qartë që mësimdhënia në institucionet e arsimit të lartë realizohet nëpërmjet formave kryesore të mësimdhënies të përcaktuara në syllabusin e lëndës përkatëse, nëpërmjet leksioneve, seminareve, laboratoreve, detyrave të kursit, ushtrimeve praktike, esseve si edhe praktikave profesionale, të cilat synojnë të zhvillojnë kompetencat profesionale tek studentët.</p>

<p>diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Personeli akademik i këtij programi studimi i konsideron diskutimet dhe punën në grup si elemente të rëndësishëm në interpretim apo zgjidhjen e problematikave të ndryshme.</p> <p><i>Sugjerojmë që njësia bazë duhet të shtojë përpjekjet për angazhimin e studentëve në projekte kërkimore e shkencore, pasi aktualisht konstatojmë që nuk rezultojnë studentë të angazhuar në ndonjë projekt pavarësisht faktit që institucioni i mbështet studentët duke i informuar ata nëpërmjet faqes zyrtare të universitetit për mundësitë e bursave të studimit apo programe të ndryshme në kuadër të projekteve Erasmus.</i></p> <p>Evidenca 3.14</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua gjatë takimeve me stafin akademik të programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” mbi aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat personeli akademik dhe ndihmës trajnohet dhe teston metoda të reja mësimore.</p> <p>Këto trajnime realizohen kryesisht në kuadër të shkëmbimeve ndërkombëtare për trajnimin e stafit, apo aktiviteteve të mirëfillta trajnuese të organizuara nga Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve si dhe Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Aktivitetet trajnuese, objektivat, efektet dhe pritshmëritë analizohen dhe raportohen në strukturat përkatëse.</p> <p>Personeli akademik ka lirinë akademike e profesionale të testojë metoda të reja në mësimdhënie, dhe duke qenë se silabuset e lëndëve rishikohen çdo vit, ka mundësi të reflektojë përshtatjet dhe ndryshimet e nevojshme, në përputhje me rezultatet e përdorimit të tyre në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies tek studentët. Vlen të theksohet që stafi është i lirë të sugjerojë metoda që kanë rezultuar pozitive dhe të diskutojnë rreth tyre, me qëllim përhapjen e praktikave më të mira.</p> <p>Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte organizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë. Një aktivitet i tillë ka qenë edhe takimi i anëtarëve të stafit akademik të departamentit dhe Rektorit të Universitetit me përfaqësues të Federatës Shqiptare të Futbollit i cili kishte në fokus të tij temën mbi pjesëmarrjen e studentëve në kursin e "Përgatitësit fizik" dhe pajisjen e tyre me licencë.</p> <p>Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte vazhdimisht organizon aktivitetet jashtë strukturës së programit të studimit që nxisin jo vetëm formimin e mëtejshëm të studentëve por pasurojnë edhe anën sociale të tyre. Studentë të Departamentit të Edukimit Fizik e Sporte janë pjesë e ekipeve sportive të Volejbollit, Basketbollit Hendbollit, Futbollit, Pingpongut dhe Tenisit që</p>

	përfqësojnë USH dhe Shoqatën Sportive të USH, në kampionatet sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Sportit Universitar.			
	Evidenca 3.15			
	Evidenca XLVI			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>GVJ konstaton se procedura për provimin final para diplomimit të studentëve është e hartuar qartë dhe e publikuar në faqen e internetit, nga ku studentët mund ta aksesojnë lehtësisht.</p> <p>USH-ja ka hartuar udhëzuesin e provës finale ku jepen udhëzime për procedurat e përgatitjes dhe realizimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar. Temë diplome bëjnë vetëm ata studentë me notë mesatare së paku 8.5 dhe që bëjnë kërkesë me shkrim.</p> <p>Kjo paketë udhëzimesh përmban të gjitha elementet për procedurat e përgatitjes, të konsultimeve, të monitorimit, të vlerësimit të punës trevjecare; përmban përgjegjësitë e seicilës palë që përfshihet në realizimin e kësaj veprimtarie përmbyllëse të programit të studimit.</p> <p>Për të fituar diplomën Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” studenti duhet të ketë marrë 180 kredite dhe të marrë provën finale që realizohet me provim final apo mbrojtjen e diplomës.</p> <p>(Evidenca 1.3, Kreu V, neni 26,27,28)</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Çdo informacion dhe udhëzimet mbi provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve në USH-së është i publikuar dhe i aksesueshëm për të gjithë studentët. Pedagogët përgjegjës plotësojnë një fond pyetjesh nga disiplinat kryesore të programit të studimit për lëndën e provimit të përgjithshëm përfundimtar.</p> <p>Nga vizita në universitet, vërehet që studentët përzgjedhin lektorin sipas fushave të interesit. Pedagogët punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kërkimore-shkencore.</p> <p>Gjithashtu për departamentin është shumë e rëndësishme puna paraprake me studentët, konsultimi i pyetjeve dhe takimet sqaruese me titullarët e lëndëve</p>

	<p>përpara provimit të përgjithshëm përfundimtar apo provimit final dhe konsultat metodologjike për mbrojtjen e diplomës.</p> <p>Në mbledhjen e veçantë të njësisë bazë, përcaktohen fushat dhe pedagogët përgjegjës, të cilët do të hartojnë programet orientuese. Ata përgatisin 10 teza provimi, të cilat futen në zarfe dhe ditën e provimit, studentët përzgjedhin 2 prej tyre. Në rastet e mbrojtjes së temave të diplomës, fillimisht përcaktohen fushat përkatëse për studim, më pas studentët përzgjedhin pedagogë përkatës sipas fushave.</p> <p>Pedagogët udhëheqës udhëheqin studentët në përzgjedhjen e literaturës, realizimit të punimit të diplomës, udhëzime specifike lidhur me punimin e prezantimin final të saj.</p> <p>Evidenca 3.16</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Provimi final në USH është i përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve të tyre. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së tyre ECTS në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera.</p> <p>Nga viti akademik 2019-2020 peshat do të jetë 80% lëndë të kategorisë B dhe 20% lëndë të kategorisë C. Pyetjet janë cilësore dhe forma e zgjidhjes së tyre është me zhvillim e cila teston realisht nivelin e përgatitjes dhe formimit të studentit.</p> <p>Komisioni i Departamentit përgatit provimin final bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar.</p> <p>Evidenca 3.17</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave dhe evidencave GVJ konstaton se në USH për të fituar diplomën e studimeve Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” studentët, përveç arritjes së rezultateve pozitive të kursit dhe kryerjes së praktikës, duhet t'i nënshtrohen edhe provës finale (provim formimi) apo ata me mesatare mbi 8.5 me mbrojtje diplome nëse e kërkojnë.</p> <p>Pedagogët japin udhëzime dhe bëjnë konsultime me studentët për procedurat e përgatitjes, të udhëheqjes, të monitorimit, të prezantimit dhe të vlerësimit të punimit të provës finale. Secila palë mban përgjegjësitë që përfshihen në realizimin e kësaj veprimtarie përmbyllëse të ciklit të studimeve bachelor.</p> <p>Komisioni që ngrihet për vlerësimin e studentëve në provimin final apo mbrojtjes së temës së diplomës të programit të studimit Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”, bazohet në procedurat e përshkruara hollësisht të paketën e provës finale.</p>

	(Evidenca 3.18)
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>USH-ja ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme, si dhe staf ndihmës për të asistuar studentët për kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve të ndryshme ndonëse temat e diplomave në bachelor janë kryesisht të karakterit teoriko empirik apo përmbledhje literature.</p> <p>Pegagogu udhëheqës mban kontakte të vazhdueshme me studentin diplomant gjatë javës dhe e asiston edhe në mjedise sportive për realizimin e pyetësorëve apo testeve ku në këtë rast një ndihmë e madhe është edhe koordinatori i programit të studimit.</p> <p>Institucioni mund të ndihmojë studentët, duke shpërndarë pyetësorët e tyre, tek studentët e tjerë në USH nëpërmjet koordinatorëve ose me anë të paisjes me një vërtetim zyrtar i mundëson studentit mbledhjen e të dhënave edhe jashtë USH-së.</p> <p>Evidenca 3.17</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Komisioni i vlerësimit të temës së diplomës përbëhet nga 3 pedagogë ose specialistë të fushës. Ata duhet të jenë me tituj dhe grada.</p> <p>Për vlerësimin e diplomës anëtarët e komisionit të vlerësimit mbajnë parasysh disa kritere si demonstrimin e një vetëdije profesionale në trajtimin e temës së zgjedhur; përdorimin e metodologjisë shkencore dhe të instrumenteve të kërkimit; origjinalitetin e punimit; cilësinë e të shkruarit (respektimi i stilit shkencor të të shkruarit, respektimi i rregullave të drejtshkkrimit); cilësinë e prezantimit etj.</p> <p>Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit.</p> <p>Rezultati përfundimtar shënohet në procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve.</p> <p>Evidenca 3.19</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 180 ECTS dhe provimin final apo mbrojtjen e diplomës, zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin.</p> <p>Deri në momentin e pajisjes me diplomë të të diplomuarve, USH lëshon një vërtetim për diplomën e fituar, të shoqëruar me certifikatën dhe suplementin e diplomës sipas formateve të liçensuara dhe të aprovuara nga MAS në përputhje me aktet rregulluese dhe është regjistruar pranë QSHA. Vetë diploma firmoset nga Rektori dhe Dekani.</p>

	<p>Pajisja e studentit me diplomë është e përcaktuar në Rregulloren e Studimeve të USH dhe konkretisht në pikën 1, studenti pas diplomimit pajiset me diplomën përkatëse shoqëruar me diplomën supëlement.</p> <p>Gjithashtu, Sipas Rregullores së Programit të Studimit në përfundim të studimeve studenti pajiset me dokumentacionin e detyrueshëm që janë diploma dhe suplementi i diplomës, si edhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> <p>Evidenca II, neni 38</p> <p>Evidenca 1.3 Kreu V, neni 29</p> <p>Evidenca 3.20</p>
--	---

<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Universiteti arkivon dokumentacionin e studentit pas diplomimit në zyrat e arkivës. Rast pas rasti, bazuar në kërkesat specifike të studentëve, lëshohen vërtetime për qëllime të ndryshme.</p> <p>Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat informacionit dhe paisjen e me informacionin e Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Këto të dhëna janë të regjistruara dhe të ruajtura pranë sekretarive mësimore përkatëse e cila përbën regjistrin themeltar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të dhënat bazë i dërgohen Qendrës së Shërbimeve Arsimore.</p> <p>Konstatohet si GVJ se fillimisht në Universitetin e Shkodrës ka shërbyer platforma ESSE 3 si sistem informatik i integruar për të dixhitalizuar punën dhe procedurat mësimdhënëse si dhe procedurat administrative të sekretarive mësimore dhe aktorëve të tjerë të universitetit, ndërsa aktualisht sistemi Pitagora garanton ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të studentit për një periudhë të caktuar dhe paraqet/informacione për studentin nëse kërkohen.</p> <p>Evidenca XXII</p> <p>Evidenca XXIII</p>
--	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushja			
	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushja			
	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>USH disponon Rregulloren e Burimeve Njerëzore e cila synon të sigurojë një menaxhim aktiv të burimeve njerëzore duke hartuar dhe zbatuar procedura e rregullore, politika, programe dhe shërbime që kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të institucionit dhe punonjësve duke bërë balancimin e duhur të nevojave të punonjësve dhe nevojave të institucionit.</p> <p>Vizioni i USH-së është bashkëpunimi me profesionistë duke ofruar shërbime, politika dhe sisteme të burimeve njerëzore innovative, të orientuara drejt rezultateve.</p> <p>Nga dosjet e personelit akademik dhe CV-të e tyre dalim në konkluzionin se: Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, i përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Gjithashtu evidencat na pasqyrojnë që mbi 70% e programit mësimor realizohet nga PAE apo stafi akademik me kohë të plotë konform udhëzimeve në fuqi.</p> <p>Në Ligjin nr. 80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 59, pika 6 është e përcaktuar se “Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës”.</p> <p>Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte, për vitin akademik 2022-2023, përbëhet nga 16 anëtarë të stafit akademik me me kohë të plotë, të cilët zotërojnë gradat dhe titujt si mëposhtë:</p> <p>Personel Akademik Efektiv (PAE):</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof.As, - 1 Prof. Dr - 7 Doktorë - 7 Msc <p>Personel Akademik me Kontratë (PAK):</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof.Dr - 3 Doktorë - 26 Msc

	<p>Personel Ndhimes Akademik (1).</p> <p>Mbështetur në sa më lart personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte përmbush kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p>Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte për ofrimin sa më me cilësi të programit të studimit përpiqet të angazhojë personel akademik me kohë të pjesshme me tituj akademikë dhe që janë specialistë të fushës.</p> <p>Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit Bachelor në Edukim fizik e sporte në përgjithësi janë në përputhje me programin studimit dhe natyrën dhe specifikën e moduleve.</p> <p>DEFSH për të ofruar lëndët specifike të programi të studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte si psh Anatomji dhe Fiziologji Humane, Biokimi-Biologji e Aktivitetit Fizik e Sportit, Fiziologji dhe Biomekanikë e Ushtrimit, bashkëpunon me Departamentet e Infermjerisë, Biologjisë, Shkencat e Natyrës për të mbuluar me pedagogët e këtyre departamenteve këto lëndë specifike, duke paraqitur para fillimit të vitit akademik pranë departamenteve përkatëse një kërkesë.</p> <p>Në mbështetje të realizimit të programit të studimit është gjithashtu edhe personeli ndihmës akademik.</p> <p><i>GVJ rithekson problematikën e mungesës së gradave dhe titujve tek rreth 44% e pedagogëve të brendshëm që përbëjnë themelin e këtij programi studimi. Me hapjen e programeve të Ciklit të Tretë të studimeve duhet të fillojë aplikimi për doktoraturë. Gjithashtu duhet parë me kujdes ekspertiza e stafit akademik MSc sepse në jo pak lëndë gjykojmë që nuk justifikohet kualifikimi i thelluar.</i></p> <p>Evidenca 1.5 Tab 1</p> <p>Evidenca 4.1 Tab 7</p> <p>Evidenca 1.10</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në njësinë kryesore që mbulon këtë program studimi konstatojmë që personeli akademik efektiv mbulon mbi 70% të ngarkesës mësimore për programin e studimit në përputhje kjo me bazën ligjore në fuqi.</p> <p>Për periudhën 2020-2023 janë angazhuar pedagogë të brendshëm të Departamentit të Edukimit Fizik e Sporte, por edhe pedagogë të brendshëm të Departamenteve të tjera që mbulojnë lëndët specifike të programit të studimit.</p> <p>Evidenca 4.1 tab 12</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Evidenca 4.2 tab 4</p> <p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur për procesin e akreditimit të këtij programi studimi, GVJ konstaton se Departamenti i Edukimit Fizik e Sporteve garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, referuar të dhënave mbi personelin akademik efektiv që mbulon programet e studimit subjekt të këtij raporti vleresimi.</p> <p>Universiteti i Shkodrës si subjekt tatimpagues nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datën 06.01.2023.</p> <p>Evidenca 1.5 tab 2</p> <p>Evidenca 4.3</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar bazë ligjore dhe nën ligjore për rekrutimin e personelit të brendshëm dhe të jashtëm akademik, e mbështetur dhe në rregullore të brendeshme. GVJ e pa në terren dhe e gjen të mbështetur në ligj plotësisht procedurën e ndjekur për rekrutim.</p> <p>Bazuar në Statutin e USH, institucioni zbaton procedura transparente të rekrutimit si të stafit akademik me kohë të plotë po ashtu edhe të stafit akademik me kohë të pjesshme në përputhje me bazën ligjore në hartimin e ofertës së punës, kriteret e pranimit, shpalljen e vendit të punës, ngritjen e komisioneve, vlerësimin e dosjeve, zhvillimin e konkursit, informacionin përfundimtar dhe vendimin e emërimit.</p> <p>Kriteret e përgjithshme përcaktohen në Rregulloren e Punësimit ndërsa kriteret specifike përcaktohen nga njësi bazë dhe miratohen nga rektori. Konkursi i punësimit të personelit akademik në USH drejtohet nga një komision ad-hoc, i përbërë nga tre përfaqësues të departamentit, një përfaqësues i njësisë kryesore dhe një i rektoratit.</p> <p>Shpallja bëhet online në faqen zyrtare të USH në seksionin njoftime për punësim si edhe në buletin e APP-së.</p> <p>Evidenca I Neni 43</p> <p>Evidenca XI, Neni 8</p> <p>Evidenca 4.4</p> <p>Evidenca 4.5</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e</p>	<p>Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte asistohet nga personeli ndihmës akademik në mirëmbajtjen e palestrës në të</p>

<p>mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>cilën zhvillohen orët e ushtrimeve sipas lëndëve/moduleve përkatëse.</p> <p><i>GVJ bazuar edhe në të dhënat e personelit ndihmës akademik gjykon që për një program të tillë studimi 1 (një) personel është i pamjaftueshëm për t'ia dalë mbanë përgatitjes së terreneve dhe bazës materiale për një orë mësimi konform standarteve akademike.</i></p> <p>Evidenca 1.5, tab 2</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vlerësimit të situatës në terren, pamë që zyra e burimeve njerëzore mbledh, ruan dhe përditëson në çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programet e studimit, si ata me kohë të plotë, ashtu edhe personelin me kohë të pjesëshme.</p> <p>Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, në çdo semestër dhe vit akademik.</p> <p>Të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit mblidhen ruhen dhe përditësohen nga institucioni në çdo vit akademik. Këto të dhëna depozitohen në arkivën e departamenti si psh CV-të e personelit akademik, por janë të plota dhe në dosjen personale që ruhet në zyrën e burimeve njerëzore të institucionit.</p> <p>Evidenca 1.6</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se DEFS, mbështetur në marrëveshjet e bashkëpunimit me DRAP Lezhë, realizon praktikat mësimore që zhvillohen në kuadër të lëndës “Orientim në mësuesi” në programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte, në instituconet e arsimit parauniversitar.</p> <p>Gjithashtu njësia bazë ka në përbërjen e tij personel akademik efektiv të kualifikuar që udhëheqin dhe mbikëqyrin studentët në punimet e diplomës apo veprimtari të tjera që përmban programi i studimit.</p> <p>Pedagogë të kualifikuar të Departamentit të Edukimit Fizik e Sporte janë anëtarë të grupit të themelimit të Shoqatës Sportive në USH.</p> <p>Evidenca 1.8</p> <p>Evidenca 1.5, tab 2</p> <p>Evidenca 4.6</p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të</p>	<p>Në kurrikulën e programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte, në vitin e tretë të studimeve, studentët zhvillojnë lëndën e orientimit.</p> <p>Në modulën Orientim në Mësuesi të kësaj lëndë zhvillohen orë praktikash vëzhguese të mësimit në institucionet e arsimit parauniversitar, në bazë të marrëveshjeve me DRAP Lezhë.</p> <p>Pedagogu i lëndës mbikëqyr studentët në ambientin pritës, i ndihmon studentët</p>

praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	të përmbushin detyrimet e praktikës dhe bën vlerësimin e tyre. <i>GVJ e konsideron të domosdoshëm rikthimin e mentorëve (me pagesë), pra mësueve (në institucionet shkollore) të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e praktikës mësimore në institucionet parauniversitare gjë e cila do të rrishte interesin e tyre për t'ju përkushtuar studentëve në çdo hap të praktikës. Kjo duhet kërkuar në nivelet e politikëbërjes së politikave arsimore nga titullarët më të lartë të IAL-së.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Universiteti i Shkodrës siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, duke iu përgjigjur numrit të studentëve, grupeve mësimore si edhe natyrës specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> <p>Në planimetrinë e FSHSH-së shikojmë që për DEFS-në janë në dispozicion 633.5 m² ka vlen të theksohen 4 salla nga 54.2, 64.7, 54.7 dhe 36 m². Nga viti 2021 e në vazhdim Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte zhvillon veprimtarinë mësimore pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore duke garantuar mjediset e nevojshme për një proces mësimor cilësor.</p> <p>Deri në vitin 2021 Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte e ka realizuar veprimtarinë mësimore teorike në ambientet e FSHE-së dhe veprimtarinë praktike në palestrën që disponon, por edhe në stadiumin e qytetit të Shkodrës dhe Fushën “Reshit Rusi” në sajë të marrëveshjes së bashkëpunimit që disponon USH-ja me Bashkinë Shkodër.</p> <p>1.7 Planimetria e FSHE-së</p> <p>Evidenca 1.8</p> <p>Evidenca 1.9</p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes	<p>Mjediset mesimore janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjise se informacionit, të cilat garantojnë realizimin e procesit mesimor. Nje nga objektivat kryesore strategjike të USH-së është digjitalizimi. Në Universitetin e Shkodrës të gjithë auditorët janë të pajisur me smartboard dhe sisteme projektimi digjital, përfshirë të gjitha mjetet e</p>

<p>përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>tjera të nevojshme audio dhe video.</p> <p>Për realizimin e procesit mësimor klasat janë të pajisura me mjete të teknologjisë së informacionit si videoprojektorë gjë e cila mundëson një mësimdhënie bashkëkohore.</p> <p>Gjithashtu edhe palestra e Departamentit të Edukimit Fizik e Sporte disponon mjetet dhe hapësirën e nevojshme për të realizuar orët e praktikave sportive.</p> <p>Evidenca 1.7</p> <p>Evidenca 1.8</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>USH për lëndët dhe programet e IT ka infrastrukturë të përshtatshme teknologjike ku janë instaluar sisteme operative si Ëindoës XP; Softëare: MySql, Java. Bluel, Microsoft Visual Studio, SPSS, XAMPP, AutoCad, PhotoShop, Revit.</p> <p>Janë vënë në dispozicion dhe ambjentet sportive të plotësuar me aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p>Për natyrën specifike të programit të studimit Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte, realizon orët praktike të lëndëve dhe moduleve të programit të studimit në palestrën që disponon, por edhe në stadiumin e qytetit të Shkodrës dhe fushën “Reshit Rusi”</p> <p>Këto ambiente sigurojnë hapësirën e nevojshme dhe disponojnë bazën e nevojshme materiale për të plotësuar kërkesat dhe objektivat formuese të programit të studimit në tërësi.</p> <p><i>GVJ nuk gjeti një dokument mbi blerje të reja për bazë materiale laboratorike ose për praktikat sportive. Gjykojmë që njësia bazë me mbështetjen e dekanatit duhet të kërkojnë një buxhet të dedikuar sipas nevojave të programit të studimit.</i></p> <p>Evidenca 1.8</p> <p>Evidenca 1.9</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Krahas lëndës së teknologjisë së informacionit studentët bëjnë edhe lëndë të kërkimit shkencor në laborator ku janë të instaluar programet e nevojshme, si Excel dhe SPSS.</p> <p>Ndërkohë, të gjitha klasat janë të pajisura me projektor, kompjuter / lap top dhe internet me lidhje fikse dhe ëifi. Edhe palestrat janë të pajisura me mjetet e nevojshme.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Edukimit disponon laboratorin e teknologjisë së</p>

	informacionit TASK i cili është i pajisur me programe profesionale dhe studentëve të Departamentit të Edukimit Fizik e Sporte u shërben për të realizuar Lëndën e Kërkimit Shkencor.			
	Evidenca 4.7			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Studentët e këtij programi studimi kanë gjithmonë mundësitë e shfrytëzimit të literaturës bazë dhe asaj të rekomanduar në syllabuset e lëndëve/moduleve.</p> <p>Personeli akademik u ofron studentëve të këtij programi studimi literaturë bazë dhe ndihmëse përmes leksioneve, Ëbsite-ve, librave apo cikleve të leksioneve të rifreskuara, të cilat garantojnë marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p> <p><i>GVJ e ka theksuar edhe më lart që stafet akademike duhet të jenë më të kujdesshëm në përcaktimin e literaturës së huaj sepse jo të gjithë studentët kanë mundësinë të komunikojnë rrjedhshëm në shkrim dhe lexim (dysHEMEJA e notës mesatare në hyrje shkon 5.22), plus që çdo temë në syllabus duhet të ketë të përcaktuara faqet respektive në literaturën e përcaktuar në syllabus.</i></p> <p>Evidenca 2.7</p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	<p>Në fillim të çdo viti akademik, Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte raporton për përditësime të literaturës me botime të fundit dhe bën kërkesë për pasurimin e fondit të Bibliotekës me këto botime.</p> <p>Gjithashtu pedagogët e departamentit kontribuojnë edhe vet në pasurimin e këtij fondi duke i dhuruar BUSH-së botime të ndryshme që disponojnë.</p> <p><i>GVJ nuk gjeti asnjë dokument i cili të vërtetojë kërkesën nga njësia bazë për blerje librash botime të pesë viteve të fundit. Theksojmë që zyra e financës dhe administratori duhet të kenë një fond të dedikuar për libra e broshura për çdo program studimi. Gjithashtu pedagogët e njësisë bazë duhet të fokusohen edhe në botimin e tekseve akademike të miratuara nga dekanati, rektorati dhe Senati Akademik për botim.</i></p> <p>Evidenca XXVIII</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion konstatuam që USH vë në dispozicion të studentëve Bibliotekën mësimore e cila ofron një numër të mjaftueshëm botimesh në fushën e Edukimit Fizik dhe ofron hapësira të mjaftueshme dhe mjaft komode për përdorim nga studentët gjatë përgatitjes së tyre mësimore gjë e cila garanton mundësinë e shfrytëzimit të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu studentët kanë akses në U-library e cila është iniciuar dhe mbështetur nga MAS dhe është një risi që ka shtuar larminë e burimeve për materiale e literaturë në fusha të ndryshme të studimit.</p> <p><i>Nga dokumentacioni shikojmë që për këtë program studimi janë në bibliotekë rreth 377 tituj librash me vite botimi nga viti 1947-2018. Ku 94% e tyre janë shqip dhe 6 % gjuhë e huaj!!! Kjo disballancë duhet rregulluar mundësisht me leading books kryesisht nga Human Kinetics sepse biblioteka shfrytëzohet jo vetëm nga studentët, por edhe nga pedagogët, sidomos ata të rinj.</i></p> <p>Evidenca 4.8 Evidenca 4.9</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Njësia qendrore e bibliotekës ka dhe shërben për arkivimin e një kopjeje të çdo libri fizik që ka biblioteka (dhe të çdo libri të ri që hyn në bibliotekë), arkivimin e dokumentacionit të bibliotekës, arkivimin e punimeve të diplomave të studenteve, si dhe vend-adresimi i stafit apo studenteve për çdo nevojë apo problematikë që lidhet me bibliotekën.</p> <p>Totali i titujve në bibliotekën e FSHE-së është 6265 tituj.</p> <p>Ndërkohë, studentët e programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte", kanë mundësi të shfrytëzojnë një numër prej 377 tekstesh në bibliotekën fizike të FSHE-së dhe më shumë tituj në aksesin që kanë në bibliotekën online.</p> <p>Librat e programit disponohen në dominancë në 3/5 kopje. Ndërsa revistat janë në numër më të madh. Mbetet vetëm që studentët të frekuentojnë më shumë ambjentet e saj.</p> <p>Biblioteka ofron për studentët literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, të mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo faqe online të nevojshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore në fushën e edukimit sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> <p>Evidenca XXVIII</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për</p>	<p>Në Universitetin e Shkodrës, studentët mund të shfrytëzojnë pa pagesë bibliotekat online. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies,</p>

<p>studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line, përmes U-library dhe revistat elektronike</p> <p>Në shërbim të studentëve është edhe OPAC (Online Public Access Catalog) i cili lejon kërkimin në të gjithë fondin e BUSH. Revistat online janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Edëard Elgar publishing -Taylor & Francis Online -IFLA Journal -Ariadne -D-Lib Magazine -Library of Congress Publications etj. <p>Evidenca XXVI Evidenca 4.9</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Bibliotekat janë të pajisura me poste leximi dhe kompjutera, për ofrimin dhe aksesimin në bibliotekën dixhitale të universitetit dhe të bibliotekave online ndërkombëtare.</p> <p>Menaxhimi i librave të bibliotekës bëhet nëpërmjet sistemit të platformës online, i cili mundëson menaxhimin e librave të kategorive të ndryshme, kontrollimin me lehtësi për kthimin, vonesave, humbjes apo dëmtimin e librave.</p> <p>Platforma ofron të gjitha opsionet e nevojshme për anëtarët në mënyrë që procesi i kërkesave drejtuar bibliotekës të jetë sa më i lehtë.</p> <p>Ky proces ndiqet dhe menaxhohet lehtësisht nga stafi i bibliotekës përmes postës elektronike.</p> <p>Evidenca XXVI Evidenca 4.9</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në dispozicion të studentëve dhe stafit për të gjithë kohëzgjatjen e orarit zyrtar të punës së institucionit. Kjo nga mëngjesi deri pasdite, me të gjitha kapacitetet e saj. Pedagogët duhet të nxisin më shumë frekuentimin dhe shfrytëzimin e ambjenteve të bibliotekës nga studentët.</p> <p>Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre (nga e hëna – të premte ora 8:00- 19:00 dhe të shtunë 8:00-13:00), në përgjigje edhe të nevojave të stafit akademik dhe studentëve.</p> <p>Po ashtu, ofron salla me hapësira bashkëkohore komode e të mirëndriçura që mbulon një numër të konsiderueshëm studentësh. Ndërtesa e bibliotekës paraqet kushte mjaft të mira, duke qënë se është një ndërtesë trekatëshe me hapësirë të mjaftueshme për akomodimin e studentëve.</p>

	Evidenca 4.8			
	Evidenca 4.9			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	<p>Universiteti i Shkodrës bën përpjekje për të pasuruar fondin e bibliotekës në funksion të stafit dhe të studentëve, sipas kërkesave për tekste apo botime që bëhen nga vetë departamenti, përveç fondit ekzistues që disponon BUSH</p> <p>Gjithashtu si stafi akademik ashtu edhe studentët kanë në shërbim të tyre edhe faqen zyrtare të bibliotekës universitare Ref Link, ku mund të përdoren arkivat digjital, OPAC, revista elektronike prej ku mund të aksesohen artikuj të ndryshëm shkencor.</p> <p>GVJ konstaton se nuk ka të dhëna apo një databazë nga ana e bibliotekës ku të jepet frekuentimi i saj si nga studentët dhe stafet pedagogjike si dhe për kërkesat apo nevojat që ata kanë gjë e cila do të ishte një bazë e mirë në përcaktimin e fondit për pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj.</p>			
	Evidenca XXVIII			
	Evidenca 4.8			
	Evidenca 4.10			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmirësim	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>USH-ja disponon një sistem për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe sistemeve të tjera të koordinuara mirë mes tyre, si për pjesën administrative edhe për pjesën akademike. Ekzistojnë platformat e menaxhimit të studentëve etj.</p> <p>Portali studentor është një sistem në përdorim nga studentët i cili ju mundëson atyre të informohen në kohë reale lidhur me rezultatet e tyre akademike. Marrin informacion mbi lektorët dhe të dhëna të tjera të ndryshme me rëndësi.</p> <p>Për periudhën akademike objekt të këtij raporti vlerësimit, institucioni ka pasur në përdorim sistemin online të menaxhimit ESSE 3 i cili është menaxhuar nga profesionistët e IT-së dhe tashmë është ai është zëvendësuar me sistemin (Pitagora) nëpërmjet të cilit administrohet i gjithë informacioni që lidhet me pedagogët, sekretarinë mësimore si edhe studentët që nga regjistrimi e deri në diplomimin e tyre.</p>

	<p>Njësia bazë së bashku me sekretarinë mësimore disponojnë informacion për çdo student që nga momenti i regjistrimit dhe deri në përfundim të ciklit të studimeve.</p> <p>Evidenca XXIII</p> <p>Evidenca XXIV</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>I gjithë dokumentacioni i nevojshëm është i aksesueshëm, i kategorizuar sipas njësive të ndryshme. Gjithashtu, sistemi për komunikimin e brendshëm përfshin komunikimin online me platformat e vëna në dispozicion si edhe me anë të intranetit të monitoruar nën domainin e universitetit dhe komunikimi me publikun nëpërmjet site zyrtar, medieve sociale, etj.</p> <p>SMAK është një softëare, i ndërtuar si rezultat i domosdoshmërisë për informatizimin e menaxhimit akademik. Softi është i bazuar në teknologjinë ëeb dhe si i tillë është i aksesueshëm nga çdo kompjuter i lidhur në internet. Të dhënat janë të ruajtura në një bazë të dhënash qendrore në një server, i cili ndodhet në ambientet e AKSHI-t. Përgjegjësi i departamentit plotëson të dhënat për ngarkesat e pedagogëve dhe planet mësimore.</p> <p>Evidenca XXV</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron aksesin e dedikuar, i cili garantohet nëpërmjet logimit me kredencialet personale në platformat online, sipas kategorisë së përdoruesit.</p> <p>Këto informacione u vihen në dispozicion si stafit akademik ashtu edhe studentëve, nëpërmjet shpalljes apo publikimit të dokumenteve në faqen ëeb-in e USH-së, si dhe nëpërmjet kontaktit direkt me personelin e universitetit përgjegjës për këtë detyrë.</p> <p>Sistemi Pitagora dhe aplikacioni SMAK sigurojnë akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>24-XXIV. Platforma Smak; 23-XXIII. Platforma Pitagora</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në dy vitet 2019/2021 aktiviteti mësimor dhe komunikimi, u transferua gradualisht në Microsoft teams ku studentët mund të gjenin informacionin edhe më të detajuar për lëndët e modulet, materialet mësimore, syllabusin e lëndës, vlerësimet materialet shtesë etj. Platforma ka ndihmuar në zhvillimin e mësimin online. Gjithashtu përdorimi i adresave zyrtare të e-mail-it, si për stafin akademik ashtu edhe për studentët, vijon të mbetet një ndër format kryesore të komunikimit edhe pas mbarimit të pandemisë Covid-19.</p>

	<p>Me anë të sistemit të menaxhimit fillimisht ESSE 3 e më pas Pitagora është e mundur që studentët të shohin nga profili i tyre datat e provimeve, të regjistrohen në provime, të shohin rezultatet e vlerësimit apo të dhëna të librezës së tyre.</p> <p>Ndërkohë stafi akademik, administrativ dhe studentët janë të pajisur me adresa zyrtare elektronike, duke formuar kështu një rrjet komunikimi në grup nëpërmjet email-eve. Faqja ëeb e USH shpërndan informacion në vazhdimësi për ngjarje të rëndësishme në lidhje me zhvillimet e USH. Sistemi Pitagora nuk ka te integruar platforma të komunikimit interaktiv. Komunikimi interaktiv dhe shkëmbimi i informacioneve ndërmjet personelit akademik dhe studentëve realizohet nëpërmjet platformës office365.com.</p> <p>Aktualisht, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” përdoret platforma office365.com për komunikimin me email zyrtar në rang universiteti duke përfshirë këtu pedagogë, stafe jo akademike dhe studentë.</p> <p>Evidenca XXI</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Përdorimi i sistemeve të ndryshme elektronike garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, duke mundësuar raportimin dhe të dhënat për organet drejtuese dhe titullarët, në kohë reale, për informacione të ndryshme, në mënyrë të shpejtë dhe të saktë.</p> <p>Ky sistem krijon mundësi për akses në dokumentacion si dhe mundësi komunikimi dhe feedback në rrjet si ndërmjet studentëve dhe pedagogëve, ashtu edhe ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ. Siç e përshkruam në kriterin e mësipërm, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” përdoret platforma office365.com për komunikimin me email zyrtar në rang universiteti duke përfshirë këtu pedagoge, stafe jo akademike dhe studentë.</p> <p>Kjo platformë ofron disa ëeb apps si: paketa e plotë office, OneDrive, oneNote, klasat virtuale, etj. Në faqen ëeb të USH-së janë të prezantuar të gjithë udhëzuesit që mund të përdoren si nga studentët ashtu edhe nga pedagogët lidhur me aplikacionet e kësaj platforme.</p> <p>Evidenca 3.8)</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>USH-ja publikon online të dhënat e nevojshme në lidhje me programet, ofertën akademike, strukturën, sezonin e provimeve dhe riprovimeve dhe funksionimin e Institucionit, si dhe dokumentacionin ligjor të tij. Informacionet publikohen në faqen e internetit në të paktën ne dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p> <p>Ëebsite zyrtar i USH-së është një faqe e pasur me informacione dhe</p>



	<p>njoftime e cila përditësohet vazhdimisht, dhe një pjesë e informacionit është edhe në gjuhën angleze. Gjithashtu në këtë faqe, në rubrikën njoftime publikohen aktivitete të ndryshme të studentëve, stafit akademik, mundësitë për programe shkëmbimi për studentët, njoftimet për mundësi punësimi për personel akademik efektiv apo me kontratë, njoftimet për bursa të ndryshme studimi etj, konferenca të ndryshme, planet mësimore, oraret provimeve dhe riprovimeve.</p> <p>Evidenca 3.2; Evidenca 3.3; Evidenca 3.14; Evidenca 4.5</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet Zyrës së Financës nën drejtimin e Administratorit hartojnë çdo vit raportet me të dhëna të hollësishme, financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si dhe të veprimtarive që lidhen me kërkimin shkencor dhe kualifikimin e personelit dhe mbi bazën e tyre bëhen parashikime për periudha afatmesme.</p> <p>Institucioni bën analizë kostoje dhe të ardhurash për koston e njësisë bazë. Kjo analizë merret parasysh edhe në parashikimin e ndarjes së përballimit të shpenzimeve në grant dhe të ardhura kur përgatitet projekt buxheti dhe buxheti për institucionin në tërësi bazuar në nevojat dhe parashikimet e çdo njësie bazë.</p> <p><i>GVJ nuk gjeti një tabelë të nevojave për mjete apo bazë material didaktike apo laboratorike që njësi bazë ia drejton zyrës së financave apo administratorit. Gjithashtu nuk gjejmë projekte që njësi bazë të ketë aplikuar në agjensitë financuese të MASH-it ku dihet që MASH vetëm për vitin 2023 në kuadër të ndërkombëtarizimit të uninversiteteve ka vënë në dispozicion të financimit të projekteve mbi 300 milionë lekë të rinj.</i></p> <p>Evidenca 4.11</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e</p>	<p>Në dokumentacionin është paraqitur plani financiar, raporti vjetor me të dhëna të plota mbi financimin e burimeve njerëzore, shpenzimeve financiare operative. Paraqiten të dhëna mbi strategjinë, misionin dhe detyrimet financiare, grantet të cilat likujdohen me korektesi etj.</p> <p>Objektivat, aspektet ekonomike, kurrikulumin, buxhetin sipas zërave dhe</p>

<p>mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>viteve etj. Të ardhurat kryesore sigurohen nga tarifat e studenteve, nga donatorë të ndryshëm, konferencat që zhvillohen dhe shërbime të tjera. <i>Më shumë kujdes duhet në planifikimin periodik të fondit për bibliotekën ku çdo program studimi duhet të ketë shumën e tij të dedikuar.</i></p> <p>USH me qëllim plotësimin e nevojave të fakulteteve, krijimin e kushteve bashkëkohore për mësimdhënie, përmirësimin e cilësisë së akomodimit të studentëve, digjitalizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, menaxhimin e burimeve njerëzore, harton projekt buxhetin ku parashikohen zërat e mësipërm.</p> <p>Gjithashtu USH ndërmerr vazhdimisht veprime konkrete përmes shpenzimeve të ndryshme në drejtim të rekrutimit të burimeve të duhura njerëzore, mirëmbajtjes së ambienteve dhe si të FSHE-së ashtu edhe të ndërtesave të tjera përfshirë edhe Bibliotekën.</p> <p>Investime janë bërë edhe në drejtim të pajisjeve teknologjike dhe sportive për specifikën e programit të Studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte.</p> <p>Plani financiar i njësisë bazë përgjegjëse merr parasysh të gjitha kategoritë e shpenzimeve të nevojshme për përballimin e programit të studimit si shpenzime personeli akademik dhe administrativ, shpenzime utilitare, shpenzime për teknologji, dhe çdo shpenzim tjetër lidhur me programin në fjalë.</p> <p><i>GVJ gjykon që ka ardhur koha pas 17 vitesh që edhe ky program studimi të ketë laboratorët e vet të matjeve të cilësisë sportive, sepse vetëm aty mundet të kryhet kërkimi shkencor nga ana e stafëve pedagogjike dhe studentëve të cikleve të dyta të studimit.</i></p> <p>Evidenca XVII; Evidenca 4.11</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Mbështetur në kërkesat ligjore të ligjit 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Neni 116, Kontrolli dhe auditimi IAL-të kalojnë në procesin e auditimit.</p> <p>Auditimi i brendshëm në institucionet e arsimit të lartë realizohet nga GVB-ja njësi e auditimit të brendshëm të institucionit i përbërë zakonisht nga 5 veta, duke përfshirë dhe një student. Krijimi dhe funksionimi i njësisë të auditimit të brendshëm bëhen në përputhje me aktet e brendshme të institucionit të arsimit të lartë.</p> <p>Kontrolli dhe auditimi i jashtëm në institucionet e arsimit të lartë kryhen nga GVJ auditues të jashtëm, në bashkëpunim me GVB dhe grupe të tjera përfaqësuese. GVB harton raportin paraprak i cili i dërgohet Administratorit</p>

	<p>brenda dy javëve pas përfundimit të punës audituese. Raporti Vjetor i Auditimit të Brendshëm i dërgohet menaxhimit të Universitetit, dhe kur kur IAL-ja është për akreditim i dërgohet dhe ASCAL-it.</p> <p>Raportet e Auditimit të Jashtëm depozitohen edhe në ASCAL ku jepet rezultati përfundimtar për akreditimin, dhe kohëzgjatjen e tij. Këto depozitohen në faqen e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe janë lehtësisht të disponueshme për të gjitha palët e interesuara.</p> <p>Edhe Universiteti i Shkodrës si Institucion i Arsimit të Lartë i nënshtrohet rregullave të ligjit nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 10296, dt. 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar).</p> <p>USH-ja i nënshtrohet auditit financiar të brendshëm dhe të jashtëm, dhe rezultatet në të dy rastet i prezantohen organeve kolegjiale në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).</p> <p>Institucioni monitoron në mënyrë të vazhdueshme veprimet financiare dhe është në çdo moment në korrent të gjëndjes financiare duke kryer edhe rakordimet me Degën e Thesarit.</p> <p>18-XVIII. Analiza financiare 2022.</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Konstatojmë që raportet financiare mujore e vjetore janë të publikuara në faqen zyrtare të USH unishk.edu.al ku gjithkush që është i interesuar gjen një informacion të plotë dhe transparent për të gjithë aktivitetin financiar të IAL-së.</p> <p>Evidenca 4.12</p>				
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga pasqyrat financiare ndër vite, raportet e auditimit, opinionet dhe sugjerimet e Bordit, rezultojnë se Institucioni ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitetet financiare të duhura për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave nga të tretët në të ardhmen. Raporti i auditimit financiar evidenton përdorimin e të ardhurave nga tarifat e studentëve në favor të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve për studentët, prurjet e të cilave janë të mjaftueshme.</p> <p>Institucioni dëshmon se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p> <p>Evidenca XVIII</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="592 1973 798 2047"></td> <td data-bbox="798 1973 1005 2047">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="1005 1973 1212 2047">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1212 1973 1506 2047">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

			X	
--	--	--	---	--

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin e studenteve nga hyrja në dalje deri në mbarimin e plotë të ciklit akademik në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 si dhe VKM nr. 41dt. 24.01.2018 e ndryshuar me VKM nr. 879, dt. 18.12.2019, në statutin dhe rregulloren akademike të USH-së institucioni ka hartuar dhe zbaton rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte".</p> <p>Institucioni kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, në hyrjet daljet nga mësimi, realizimi i provimeve sipas kërkesave. USH-ja ka një strukturë të mirë organizuar për shërbimet studentore nga hyrja në dalje.</p> <p>Sipas statutit të USH "Pranimet e studentëve në USH në të gjitha programet e studimit bëhen sipas kriterëve dhe kuotave të propozuara nga departamenti, miratohen fillimisht në Dekanat e më pas në Senatën Akademik. Kuotat e pranimeve përcaktohen në përputhje me standardet shtetërore, kapacitetet akademike dhe infrastrukurore, të cilat verifikohen dhe certifikohen nga ministria përpara deklarimit të kuotave të pranimit".</p> <p>Gjithashtu në Rregulloren e Studimeve të USH-së e cila bazohet në ligjin e arsimit të lartë Nr.80/2015 si edhe në Statutin e USH përcaktohen procedurat mbi pranimet në USH, organizimin e studimeve, diplomimin duke mbuluar në këtë mënyrë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Evidenca I, neni 53,pika 1, Dosja 1</p> <p>Evidenca II, Kreu 2, Neni 6, Kreu III, Kreu V, Neni 35, Dosja I</p>

<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Evidenca 5.1</p> <p>Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje janë transparente për të gjithë, duke garantuar barazi dhe të drejta të barabarta për kandidatët dhe studentët e programit të studimit. Kjo përbën dhe një nga parimet e funksionit të USH-së, përshkruar në rregulloren e institucionit, rregulloren e programit, manualin e bursave e të gjithë aktet e tjera rregullatore të USH-së. Të gjitha të dhënat janë të pasqyruara dhe në ëbsite zyrtat të IAL-së dhe rrjetet sociale.</p> <p>Procedurat për hyrjen dhe ndjekjen e programit të janë të parashikuara në Rregulloren e studimit të programit Bachelor në “Edukim Fizik e Sporte” dhe e shoqërojnë studentin përgjatë programit të studimit.</p> <p>Evidenca 1.3, Kreu II, Neni 5</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit, të përzgjedhjes së studentëve, bëhen me paraqitjen e dokumenteve personale sipas kërkesave të pranimit.</p> <p>USH-ja miraton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve konkurrues për tu pranuar në programin e studimeve.</p> <p>Gjithashtu, duke respektuar afatet kohore institucioni miraton edhe kuotat e pranimeve të studentëve për vitin e caktuar akademik. Në kuotat e pranimit parashikohet edhe regjistrimi i studentëve nga trojet, të huaj, etj.</p> <p>Për tu pranuar në programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte studentët përveç përmbushjes së kriterëve të shpallura për këtë program studimi duhet ti nënshtrohen edhe një konkursi me teste fizike e koordinative. Ata njoftohen në lidhje me datën e zhvillimit të konkurseve, datën e fillimit të regjistrimit për konkurse, dokumnetacionin e nevojshem për konkurim ku përfshihet edhe kartela mjekësore si edhe tarifat e regjistrimit në sekretarinë mësimore të FSHE-së si edhe nëpërmjet njoftimeve që publikohen në faqen zyrtare të USH.</p> <p>Konkursi i pranimit në programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte bazohet mbi Rregulloret për konkuret e pranimit të cilat miratohen nga Senati Akademik. Testet e konkursit publikohen edhe në faqen zyrtare të USH.</p> <p>Evidenca 2.3</p> <p>Evidenca 5.1</p> <p>Evidenca 5.2</p> <p>Evidenca 5.3</p>

<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ, konstaton se në Universitetin e Shkodrës dhe specifiku në këtë program studimi kriteret, procedurat e pranimit, kuotat e pranimit, për programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku i cili informohet rreth tyre në sekretarinë mësimore në FSHE, por edhe në faqen zyrtare të USH dhe rrjetet sociale.</p> <p>Testet e pranimit në programin e studimit publikohen në faqen zyrtare të USH. Listat paraprake të fitueseve në programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte publikohet online në faqen zyrtare të USH-së.</p> <p>Studentët njihen me përparimin përgjatë kursit të studimit nëpërmjet sistemit Pitagora. Gjithashtu informacionet në lidhje me të transferimet, njohjen e studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, studentët mund ti kërkojnë edhe ti marrin edhe pranë Sekretarisë mësimore.</p> <p>Evidenca 5.3</p> <p>Evidenca 5.4</p> <p>Evidenca XXIII</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Periudha me e përshtatëshme për informimin e të të interesuarve për ndjekjen e këtij programi është në semestrin e dytë e mbrapa, për tju dhënë mundësi individëve që të qartësohen në atë çfarë ata do të zgjedhin dhe përse do ta zgjedhin. Forma të tjera të promovimit të programit të Edukimit Fizik dhe Sporte janë edhe broshura, fletëpalosje, të cilat publikohet në faqen ëeb, në ambjentet e institucionit, në takimet që organizohen me maturantët si edhe në media të ndryshme.</p> <p>Në faqen zyrtare të Universitetit (si edhe pranë sekretarisë mësimore, përpara fillimit të çdo viti akademik të interesuarit informohen dhe udhëzohen në lidhje me kërkesat e kriteret e programit të studimit. Gjithashtu çdo fillim viti studentët bëhen pjesë e një seminari informues që organizohet nga Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte, ku njihen me një përshkrim të detajuar të programit të studimit (kurrikulës, përshkrimin e shkurtër të lëndëve, kompetencat që realizon programi, etj), me organizimin, kreditet, kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p>5.2 Rregullore për konkurs pranimi dhe normat e pranimit.</p> <p>5.4 Kriteret, kuotat, tarifat, listat e fituesve.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik</p>	<p>Universiteti i Shkodrës harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve. Duke qënë një program studimi</p>

<p>kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.</p>	<p>në të cilin studentëve i kërkohet të përmbushin norma fizike të cilat kërkojnë që kandidati të ketë një përgatitje të lartë tekniko fizike, në kuotat e propozuara Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte nuk parashikon kuota për kandidatët me aftësi të veçanta, por parashikon kuota për studentët nga trojet dhe pakicat kombëtare.</p> <p><i>Në kuadër të ndërkombëtarizimit duhet parë edhe amendimet për pranimin e studentëve të huaj nëse ka kërkesa.</i></p> <p>Evidenca 5.1</p> <p>5.2 Rregullore për konkurs pranimi dhe normat e pranimit.</p> <p>5.4 Kriteret, kuotat, tarifat, listat e fituesve.</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>USH-ja harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret dhe të gjitha procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve për studentët e huaj.</p> <p>Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte në kuotat e propozuara që i paraqiten dekanit parashikon kuota për studentët nga trojet dhe pakicat kombëtare.</p> <p>Evidenca 5.5</p> <p>Evidenca 5.1</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Në Statutin e USH-së theksohet se studentët e USH-së kanë të drejtë të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet, bazuar në aktet ligjore përkatëse, si edhe stimuj materialë për rezultate të shkëlqyera.</p> <p>Në faqen zyrtare të USH shpallen të gjitha njoftimet në lidhje me VKM-të përkatëse për akordimin e bursave për studentë sipas përcaktimeve të VKM-ve.</p> <p>Studentët aplikojnë nëpërmjet deklaratës dhe formularit të aplikimit të cilat i gjejnë në faqen zyrtare të universitetit ngrihet komisioni AD-HOC që shqyrton aplikimet për bursë dhe reduktim të tarifës vjetore të shkollimit.</p> <p>Evidenca I, Neni 78, pika g</p> <p>Evidenca 5.6</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar procedurat dhe informacioni i detajuar lidhur me të gjithë procesin dhe përparimin akademik të studenteve. Aty parashikohen të drejtat dhe detyrat e studentëve, dokumentimi i vlerësimeve me procese të notave ku komunikimi dhe mënyra e vlerësimeve, përfshin vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin në provim, e drejta për të hyrë në provim, kriteret dhe procedura të vlerësimit, transferimi i studimeve, ndërprerja dhe rifillimi i studimeve, kohëzgjatja e programit të studimit e cila është tre vjeçare me 180 kredite me 60 kredite në vit dhe 30 kredite në semester.</p> <p>Përmes koordinatorit të njësisë bazë dhe sekretarisë mësimore, studentët informohen me detaje lidhur me secilën prej procedurave të parashikuara. Ata ofrojnë informacion për vlerësimet për secilën lëndë të zhvilluar gjatë gjithë vitit akademik, për numrin e krediteve të akumuluar për të kaluar nga një vit akademik në tjetrin, që është jo më pak se 30 kredite për të kaluar në vitin e dytë bachelor dhe jo më pak se 90 kredite për të kaluar në vitin e tretë.</p> <p>Në javën e parë të pranimit në USH, gjatë javës së akomodimit, studentët njihen me të gjithë dokumentacionin zyrtar, ambientet dhe shërbimet në funksion të tyre.</p> <p>Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte përcaktohen kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga njëri vit akademik në tjetrin. Gjithashtu në programin Pitagora, ku secili student akseson lehtësisht, ata informohen mbi përparimin e tyre akademik, oraret e provimeve etj. Këtë informacion studentët mund ta marrin edhe në sekretarinë mësimore.</p> <p>Evidenca 1.3, neni 25</p> <p>Evidenca XXIII</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. USH-ja pranon transferime të studentëve nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në institucione të tjera.</p> <p>E gjithë procedura e transferimit të studentëve dhe ekuivalentimit</p>

	<p>parashikohet në Rregulloren e USH-së, Rregulloren e programit të studimit dhe në Manualin Rekrutim, Aplikim Regjistrim, Transferim, dokumentacioni që kontrollohet nga komisioni i posaçëm.</p> <p>Në Rregulloren e Studimit të USH parashikohen kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte përcakton kriteret për pranimin e studentëve në një program të dytë studimi me kohë të plotë sips udhëzimeve të MAS.</p> <p>Evidenca II, neni 19, 20</p> <p>Evidenca 1,3, pika 8</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte janë përcaktuar kriteret dhe formatet e vlerësimit të dijeve të studentëve. Po ashtu janë parashikuar procedurat lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit, e drejta për të hyrë në provim, zhvillimi i provimeve, komunikimi i vlerësimeve dhe dokumentimi i vlerësimeve.</p> <p>Format e vlerësimit të dijeve janë parashikuar edhe në syllabusin e lëndës/modulit dhe paraqiten nga pedagogu/ia e lëndës tek studentët në çdo fillim viti e semestri.</p> <p>Pedagogu informon studentin me gojë për rezultatin e arritur, për ta bindur atë. Në rast mos bindje vazhdon procedura e ankimimit sipas rregullores.</p> <p>Bëhet kërkesë /ankesa pranë departamentit i cili ngre komisionim e pedagogeve që do ta marrin në provim, nota e të cilit është përfundimtare.</p> <p>Kontrolli i dijeve është parashikuar në Rregulloren e Studimit të USH-së dhe informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit më konkretisht në nenin 22, 23, 24, 25, 26 të kësaj rregullore. Studentët informohen në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve në programin e studimit edhe nëpërmjet Rregullores së programit të studimit Gjithashtu në syllabusin e secilës lëndë është e shprehur qartë edhe procedura e vlerësimit të dijeve dhe aftësive e kompetencave që duhet të përmbushen studentët deri në përfundim të programit të studimit ku përcaktohen edhe pikët e konvertuara në notë të cilat i bëhen me dije studentit nga pedagogu i lëndës.</p> <p>Evidenca II</p> <p>Evidenca 1.3, neni 13, 14, 15, 16, 17</p> <p>Evidenca 2.7</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar procedurat dhe informacioni i detajuar lidhur me të gjithë procesin dhe përparimin</p>

të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.

akademik të studenteve.

Në rregullore parashikohen të drejtat dhe detyrat e studentëve, dokumentimi i vlerësimeve me procese të notave. Komunikimi dhe mënyra e vlerësimeve, përfshin vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin në provim, e drejta për të hyrë në provim, kriteret dhe procedurat të vlerësimit, transferimi i studimeve, ndërprerja dhe rifillimi i studimeve, kohëzgjatja e studimit të programit e cila është tre vjeçare me 180 kredite ECTS me 60 kredite ECTS në vit dhe 30 kredite ECTS për semester.

Studentët informohen në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës si edhe diplomimit në programin e studimit nëpërmjet Rregullores së Studimit në USH gjithashtu edhe nëpërmjet Rregullores së programit të studimit. Sipas përcaktimeve të neneve të sipërpërmendura në Rregulloren e Programit të Studimit, studentët mund të mbrojnë diplomën nëpërmjet provimit përfundimtar ose me punim diplome. Për mbrojtjen e diplomës me provim përfundimtar Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte pasi miraton programin e mbrojtjes së diplomës ja u bën atë të njohur studentëve në fillim të semestrit të parë, të vitit të fundit të studimeve. Përgjegjësi i departamentit i propozon Komisionin e provimit përfundimtar dhe pasi miratohet nga Dekani i fakultetit, ky Komision harton tezat e provimit (jo më pak se 10) dhe jo më pak se 5 pyetje të fushave që janë përfshirë në program.

Diplomimi me punim diplome bëhet nga studentë të cilët kanë notën mesatare 8.5 (tetë pikë pesë) për sistemin Bachelor. Pasi Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte përcakton fushat e punimit të diplomës në fillim të semestrit të parë të vitit të fundit të studimeve, dhe jua komunikon ato studentëve, studenti paraqet kërkesën drejtuar Përgjegjësit të Departamentit të Edukimit Fizik e Sporte ku përcakton fushën e interesit dhe pedagogun që dëshiron ta udhëheqë. Edhe për mbrojtjen me temë diplome ngrihet një komision i propozuar nga Përgjegjësi i departamentit me jo më pak se tre pedagogë, dhe miratohet nga dekani. Teza e diplomës duhet të dorëzohet në departament jo më vonë se dy javë para ditës së caktuar për mbrojtje.

GVJ konstaton që nuk është paraqitur asnjë model teme diplome e mbrojtur në këtë njësi bazë nga ana e studentëve ekselentë gjë e cila duhet parë me përparësi në të ardhmen.

Evidenca II, neni 35, 36, 37

Evidenca 1.3 neni 27, 28

Evidenca 3.19

Evidenca 3.17				
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Universiteti i Shkodrës informon periodikisht të interesuarit për të ndjekur studimet në programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte përmes broshurave informuese takimeve specifike me nxënësit maturantë në shkollat e mesme të qarkut Shkdoër e Lezhë, nëpërmjet rrjeteve sociale si edhe nëpërmjet faqes zyrtare të USH, ku në seksionin këndi informues i maturantit afishohet i gjithë informacioni për maturantët e interesuar për të ndjekur programet e studimit në USH.</p> <p>Po në kuadër të informimit e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm, në USH është organizuar panairi Ëork and Study apo Ditë të Hapura në USH Gjithashtu në fillim të vitit të ri akademik studentët e rinj njihen me programin e studimit, pedagogët, ambientet dhe rregullat bazë të universitetit.</p> <p><i>Vërejmë që kuotat nga viti 2019-2022 janë plotësuar respektivisht: 88, 85, 118 dhe 85 studentë me notë mesatare hyrëse 6.5-8.5, 5.2-9.1, 5-8.91, 5.22-8.93.</i></p> <p>Evidenca XIII; Evidenca 5.7; Evidenca 5.8; Evidenca 5.9</p>			
	Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X	

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar procedurat dhe informacioni i detajuar lidhur me të gjithë procesin dhe përparimin akademik të studentëve.</p> <p>Në rregullore parashikohen të drejtat dhe detyrat e studentëve, dokumentimi i vlerësimeve me procese të notave. Komunikimi dhe mënyra e vlerësimeve, përfshin vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin në provim, e drejta për të hyrë në provim, kritere dhe procedura të vlerësimit, transferimi i studimeve, ndërprerja dhe rifillimi i studimeve, kohëzgjatja e studimit të programit e cila është tre vjeçare me 180 kredite ECTS me 60 kredite ETCS në vit dhe 30 kredite ECTS për semester.</p> <p>Në fillim të vitit akademik studentët informohen në detaje mbi, programin e studimit, syllabuset, ECTS e çdo syllabusi, kohëzgjatjen e programit të studimit nëpërmjet rregullores së programit të studimit, nga pedagogët</p>

	<p>përkatës nga sekretaria mësimore, por edhe nga pedagogët tutorë të programit të studimit.</p> <p>Evidenca 1.1</p> <p>Evidenca 2.6</p> <p>Evidenca 2.7</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Universiteti i Shkodrës dhe njësia bazë e programit të studimit që po akreditohet e kanë si praktikë pune që në takimet e para të studentëve me pedagogët e lëndëve/moduleve në nisjen e vitit akademik, studentëve përveç se u vihet në dispozicion gjithë informacioni i nevojshëm në lidhje me lëndët, modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese ata njihen edhe me Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte por edhe me pedagogët e secilit modul.</p> <p>Evidenca 2.5</p> <p>Evidenca 1.3</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në Universitetin e Shkodrës funksionon Zyra e Karrierës dhe Alumni e cila ka për qëllim informimin e vazhdueshëm dhe orientimin e studentëve të USH-së në funksion të një karriere të sukseshme në të ardhmen e afërt dhe të largët.</p> <p>Në faqen zyrtare të universitetit tek seksioni student, studentët mund të aksesojnë në seksionin Alumni dhe të regjistrohen në bazën e të dhënave të kësaj zyre si edhe të plotësojnë pyetësorin e Alumni online.</p> <p>Pedagogët e Departamentit të Edukimit Fizik e Sporte jo vetëm gjatë prezantimit me studentët e vitit të parë, por edhe në vazhdim mbështesin dhe i orientojnë studentët drejt tregut të punës, jo vetëm në fushën e studimit që ofron programi i studimit si specialistë në fushën e edukimi fizik e sporte, por edhe në profesione të tjera që kjo fushë studimi e mundëson, si trainer apo instruktor fitnesi apo kryesisht në drejtimet e aktivitetit fizik për shëndet gjë e cila u shërben të gjitha kategorive të popullatës për një cilësi jete më të mirë nëpërmjet lëvizjet dhe aktivitetit fizik.</p> <p>Evidenca 5.10</p> <p>Evidenca 5.11</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në funksion të realizimit të procesit mësimor studentëve u vihet në dispozicion nga Koordinatori i Departamentit dhe Sekretaria Mësimore, informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet.</p> <p>Veçanërisht, Koordinatorin e Departamentit dhe Sekretaria Mësimore mbajnë kontakte të rregullta me studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor</p>

	<p>në Edukim Fizik dhe Sporte" nëpërmjet komunikimeve elektronike dhe portalit studentor.</p> <p>Çdo ndryshim në orar, ose ndryshim gjatë zbatimit të tij, u njoftohet studentëve nëpërmjet email-it zyrtar nga sekretaria në lidhje me procesin mesimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në USH, u dërgohet nga Koordinator i Departamentit.</p> <p>Ata njihen gjithashtu me logjistikën dhe infrastrukturën në shërbim të realizimit të programit të studimit duke i shoqëruar në çdo ambient që i shërben realizimit të këtij programi studimi.</p> <p>Evidenca 5.10</p> <p>Evidenca 5.11</p>								
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacioni i detajuar në lidhje me programin e studimit, lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave, krediteve javëve mësimore për semester etj, mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është i publikuar në faqen e internetit të USH-së dhe i cili është lehtësisht i menaxhueshëm nga studentët edhe në distancë.</p> <p>Në fillim të çdo semestri, studentët njihen me të gjithë programet lëndore (syllabuset), ku jepen me detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar.</p> <p>Se fundmi, me mbarimin e procesit mësimor online, ky informacion tashmë është edhe pjesë e platformës teams, ku çdo student sheh gjithë materialet sipas javëve dhe temave përkatëse.</p> <p>Informacioni rreth ecuresë së programit të studimit, detyrimeve akademike për të përbushur programin, si edhe afatet kohore për të shlyer detyrimet në funksion të realizimit të programit të studimit mundësohet nga një sistem i brendshëm menaxhimi që aktualisht është Pitagora i cili ka zëvendësuar programin e mëparshëm të menaxhimit ESSE 3 në të cilën secili student mund të aksesojë lirisht edhe në distance.</p> <p>Në faqen zyrtare të univeritetit studentët informohen dhe asistohen se si mund të regjistrohen në sistemin Pitagora.</p> <p>Evidenca XXIII</p> <p>Evidenca 5.12)</p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="598 1870 790 1937">Përbushet plotësisht</th> <th data-bbox="790 1870 1013 1937">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1013 1870 1252 1937">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1252 1870 1525 1937">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="598 1937 790 1986"></td> <td data-bbox="790 1937 1013 1986"></td> <td data-bbox="1013 1937 1252 1986"></td> <td data-bbox="1252 1937 1525 1986" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>FSHE disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit Bachelor në Edukim Fizik e Sporte. Vërejmë që kuotat nga viti 2019-2022 janë plotësuar respektivisht:</p> <p>Viti 2019-20 kanë hyrë 88 studentë, Viti 2020-21 kanë hyrë 85 studentë, Viti 2021-22 kanë hyrë 118 studentë dhe Viti 2022-23 kanë hyrë 85 studentë</p> <p>Me notë mesatare hyrëse respektivisht sipas viteve si më lart: 6.5-8.5, 5.2-9.1, 5-8.91, 5.22-8.93.</p> <p>Këto të dhëna disponohen nga sekretaria mësimore.</p> <p>Evidenca 5.13</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të detajuara dhe që i pasqyrojnë më lart në lidhje me studentët e rinj të regjistruar në programin e studimit etj.</p> <p>Të gjitha të dhënat në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit e deri në diplomimin e tyre, cilësia në hyrje dhe në dalje të programit të studimit, tërheqjet nga programi i studimit apo largimet para përfundimit të programit të studimit apo mospërfundimi me sukses i vitit akademik në të cilin zhvillohet programi mësimor disponohen nga sekretaria mësimore.</p> <p>Evidenca 5.13</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat e studentëve menaxhohen nga Sekretaria mësimore nëpërmjet përdorimit të sistemit të brendshëm të informacionit për të dhënat. Gjithashtu në funksion të studentëve është edhe portali studentor, platformë ku studenti merr çdo lloj informacioni në lidhje me aktivitetin e tyre në përgjithësi.</p> <p>Këtu gjenden të hedhura të dhënat mbi: notat dhe rezultatet e provimeve, datat e zhvillimit të provimit, kreditet e fituara etj. Portali studentor u mundëson atyre të informohen në kohë reale lidhur me rezultatet e tyre akademike dhe të dhëna të tjera me rëndësi për ta. Sekretaria mësimore përpunon këto të dhëna për Dekanin dhe Përgjegjës të Departamentit sipas kërkesës. Sekretaria mësimore i menaxhon të dhënat e studentëve nëpërmjet programit Pitagora.</p> <p>Evidenca XXIII</p>

Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.

GVJ, konstaton se po ti referohemi Rregullores së FSHE-së, aty përcaktohen të gjitha funksionet e Sekretarisë mësimore e cila mbështet nga pikëpamja logjistike realizimin e programeve të studimeve të ofruara nga Fakulteti i Shkencave të Edukimit.

Ndër këto funksione në pikën (g) të nenit 24 të kësaj Rregullore shprehet qartë se Sekretaria mësimore mban përgjegjësi administrative për saktësinë e dokumentave të hartuara e të lëshuara që i përcillen për firmë instancave më të larta.


Të dhënat për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre janë online dhe në regjistrat e sekretarisë mësimore dhe të disponueshme për studentët, departamentin apo dhe universitetin gjatë të gjithë periudhës së studimit

Sistemi i menaxhimit të informacionit aktual ofron funksionalitetin e nevojshëm për stafin akademik, administratën dhe ecurinë e studentëve për gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga regjistrimi në programin e studimit, vlerësimet e deri në diplomimin e tyre. Paketa softëare PITAGORA mundëson një database optimale të dhënash mbi studentët për çdo program dhe cikël studimi.

Evidenca 1.2, neni 23,24

Evidenca 5.13

Evidenca XXIII



<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Institucioni realizon për çdo vit akademik një raport analitik kryesisht me shifra, ku prezanton cilësinë e studentëve, rezultatet e arritura prej tyre, si dhe realizimin e objektivave të departamentit për këtë program studimi.</p> <p>Raportet kryesisht trajtohen në departament me tematika të veçanta, si për frekuentimin, për praktikën etj. Ky informacion përdoret për të bërë analizën vjetore të departamentit dhe të institucionit dhe këto paraqiten në raportin vjetor. Këto të dhëna janë pjesë të punës së njësive bazë për ecurinë e programeve të studimit dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e këtyre treguesve. Departamenti në bashkëpunim me zyrën e Alumnit ruajnë komunikime të shpeshta me të diplomuarit e tyre lidhur me ecurinë e tyre në tregun e punës dhe mbështesin ata në mënyrë të mëtejshme nëpërmjet kualifikimit të vazhduar.</p> <p>Departamenti disponon përmes sekretarisë mësimore dhe IT-së të dhëna mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Gjithashtu Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte bën vazhdimisht përpjekje të gjurmojë studentët e diplomuar dhe të evidentojë shkallën e punësimit të studentëve, qoftë në përputhje me diplomën, përmes Portalit Mësues për Shqipërinë të DRAP Lezhë, qoftë jo në përputhje me diplomën.</p> <p>Konstatohet se duhen shtuar përpjekjet si nga ana e departamentit të Edukimit Fizik e Sporte, për të gjurmuar një numër sa më të madh studentësh, por edhe nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit për të pasur të dhëna edhe më të gjëra dhe të sakta.</p> <p>Evidenca 5.13</p> <p>Evidenca 5.14</p> <p>Evidenca 5.11</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore</p>	<p>Në statutin dhe në Rregulloren e Universitetit të Shkodrës parashikohet përfshirja dhe angazhimi i studentëve në organe vendimmarrëse si dhe inkurajimi i pjesëmarrjes së studentëve në vendimmarrje, organizimin e lirë dhe shprehjen e mendimit të tyre.</p>

<p>dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Ndër strukturat kryesore të përfshirjes së studentëve përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senatin Akademik; • Këshillin e Etikës; • Komisionin e Sigurimit të Brëndshëm të Standardeve të Cilësisë; • Këshillin/qeveerinë e studentëve; • Mbledhjet e departamenteve, një herë në muaj të hapura për studentët. • Grupin e vlerësimit të brendshëm (për akreditim). <p>Përfshirja dhe angazhimi i studentëve dhe/ose i përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese, bazohet në përcaktimet e Ligjit Nr 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe në Statutin e USH.</p> <p>Studentët që do të jenë anëtarë të këshillave studentorë të Fakulteteve përkatëse përcaktohen nëpërmjet procesit zgjedhor, i cili bazohet në Rregulloren e zgjedhjeve të këshillave studentore dhe vendimi për shpalljen e fituesve merret nga KIZS (Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor).</p> <p>Gjithashtu studentët në USH janë të përfaqësuar në Senatin Akademik në masën 10% në Njësinë e Sigurimit të Brëndshëm të cilësisë së Fakultetit në Grupin e Vlerësimit të Brëndshëm si edhe në Komisionin e Garantimit të Cilësisë.</p> <p><i>Nga vizita në institucion konstatoam që nga ky program studimi nuk ka përfaqësues të studentëve në Senatin Akademik apo Komisionet e Përhershme të Senatit, por vetem tek GVB-ja. Në vazhdim gjykojmë që duhet rritur prezenca dhe përfaqësimi i studentëve në këto organe sepse kjo do çonte zërin e tyre tek instrumentat politikbërëse të IAL-së.</i></p> <p>Evidenca I, Neni 80; Evidenca XXXII; Evidenca 5.15</p> <p>Evidenca I, Neni 17, pika 11; Evidenca 2.9; Evidenca 2.10</p> <p>Evidenca B; Evidenca XIV</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Studentët përfshihen në forma dhe mënyra të ndryshme në vlerësimin e procesit akademik. Sondazhi që behet nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë me pyetorë mbledh të dhëna për secilën lëndë/modul dhe secilin pedagog dhe të gjithë studentët mund të japin mendimet e tyre lidhur me proceset.</p> <p><i>Këtu vlen të theksohet se pjesmarja në plotësimin e pyetësorëve e studentëve të këtij programi studimi është e ulët.</i></p> <p>Gjithashtu, kjo njësi ka parashikuar edhe zhvillimin e fokus grupeve me studentët, megjithëse janë akoma jofunksionale, apo edhe sondazhe të tjera për të mbledhur dhe vlerësuar opinionet e tyre.</p>

	<p>Po ashtu studentët organizohen në Këshilla Studentore, një e drejtë kjo që u buron nga Neni 80 i Statutit të USH-së. Studentët kanë përfaqësuesin e tyre në NJSBC-në e Fakultetit dhe gjithashtu në GVB-në për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm ku një nga anëtarët është student.</p> <p>Evidenca I; Evidenca 5.15; Evidenca 2.10; Evidenca B</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, realizohet përmes pyetësorëve të studentëve.</p> <p>Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, kryen anketime çdo semestër, dy javë përpara mbarimit të tij, çdo vit me secilin grup, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha lëndët/modulet dhe pedagogët, të cilët i shërbejnë cilësisë së mësimdhënies. Nga të dhënat e mbledhura nga anketimi me studentët, dalin syrgjerimet për përmirësimin e programit të studimit. Studentët njoftohen për rezultatet e vlerësimeve të tyre për çështje të përmirësimit të kurrikulave dhe të mësimdhënies.</p> <p>Rezultatet e pyetësorëve përdoren nga njësia bazë dhe pedagogët përkatës për të rishikuar lëndën dhe për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënësit. Bazuar në këto vlerësime konstatojmë se janë bërë ndryshime në kurrikula dhe përmirësime të niveleve të shërbimit studentor. Të gjitha evidentimet pasqyrohen në një raport i cili shërben dhe si dokument për punën e GVB-së kjo e pasqyruar në tabelat përkatëse.</p> <p>Përfaqësuesit e studentëve në Senatin e USH marrin pjesë në mbledhjet që organizohen, shprehin mendime apo propozime që lidhen me planet mësimore, programet e studimeve, rregulloret e studimeve etj.</p> <p>Njësia bazë i përfshin studentët direkt dhe indirekt në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e tyre në to dhe përmes vlerësimit që bëjnë përmes përfaqësuesit të tyre në grupin e vlerësimit të brendshëm.</p> <p>Evidenca 3.6</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësies/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve është një proces transparent, i cili shprehet në rregulloret e USH-së, sikurse dhe në syllabusin e secilës lëndë/modul. Dhënia e argumenteve për vlerësimin e studentëve nga pedagogu i secilës lëndë/modul, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posatshtëm, janë tregues i vëmendjes që ka USH-ja ndaj transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit.</p> <p><i>Nga opinionet e studentëve rastet e ankimit janë shumë të rralla.</i></p> <p>Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e</p>

	<p>kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e pedagogut siç përcaktohet në nenin 30, pika 4 të Rregullores së Studimit në USH-së.</p> <p><i>Në Departamentin e Edukimit Fizik e Sporte nuk rezulton asnjë rast ankimi të rezultatit nga ana e studentëve gjë e cila në gjykimin tonë si GVJ, duhet analizuar dhe marrë me rezerva.</i></p> <p>Evidenca II</p>		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X	

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Universiteti i Shkodrës në funksion të informimit të studentëve ka në shërbim faqen zyrtare të USH-së, www.unishk.edu.al, në të cilën studentët nëpër rubrikat e ndryshme informohen në lidhje me programet e studimit, rregulloret e programeve të studimit si edhe mbi veprimtaritë akademike, social-kulturore që ndodhin në Universitet.</p> <p>Gjithashtu në shërbim të informimi të studentëve është edhe faqja zyrtare e USH-së në facebook në të cilën postohen të gjitha veprimtaritë apo njoftimet e ndryshme për studentët.</p> <p>Po ashtu sistemet e menaxhimit fillimisht platforma ESSE 3, Pitagora aktualisht si edhe SMAK ofrojnë shërbime lehtësuese informuese e orientuese për studentët, pedagogët dhe të interesuarit e tjerë.</p> <p>Në funksion të informimit dhe të ofrimit të shërbimeve janë edhe Zyra e Karrierës dhe Alumni, Sekretaria mësimore, pedagogët tutorë të programit të studimit ofrojnë gjithashtu informim, këshillim, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, pedagogët u prezantojnë studentëve programin mësimor për çdo lëndë, sistemin e vlerësimit, detyrimet, kërkesat lidhur me literaturën, dhe metodologjinë e mësimdhënies.</p> <p>Evidenca 5.7; Evidenca XXII; Evidenca XXIII, Dosja I</p> <p>Evidenca XXIV; Evidenca XLII; Evidenca 2.6</p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem	<p>Studentët marrin informacion në mënyrë të drejtëpërdrejtë, por dhe nga interneti në burime të ndryshme. Studentët në USH mund t'i drejtohen</p>

<p>të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sekretarisë Mësimore dhe Koordinatorit të Departamentit për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Ata mund t' i drejtohen dhe Zyrës së Alumnit dhe Karrierës, për të marrë informacion dhe këshillim për aktivitete e shërbime mbështetëse brenda dhe jashtë USH-së për, mbarëvajtjen e jetës së tyre studentore.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumni informon, këshillon, dhe asiston studentët në çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Detyra e kësaj zyre është specifike në lidhje me informimin, orientimit dhe arkivimin e dokumentacionit.</p> <p><i>GVJ sugjeron që programi i studimit të ketë dhe Dekanin e studentëve i cili do të sillte edhe më të plotë zërin e studentëve tek politikëbërja universitare.</i></p> <p>Evidenca XLII</p> <p>Evidenca 5.7</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Studentëve në USH u ofrohet informacion për karrierën duke ju drejtuar zyrës së Alumnit dhe Karrierës. Zyra e Alumnit dhe Karrierës, në bashkëpunim të vazhdueshëm me departamentet, lehtësojnë të gjithë studentët për shërbimin e këshillimit të karrierës.</p> <p><i>Në këtë drejtim duhet të punohet më shumë që studentët që mbarojnë të jenë konkretisht më shumë të informuar dhe më afër kërkesave të tregut të punës.</i></p> <p>Gjithashtu studentët orientohen për institucionet ku mund të zhvillojnë praktiken e tyre profesionale, nëpërmjet koordinorit të departamentit dhe pedagogut të përcaktuar për të mbikqyrur lëndën e praktikës profesionale të parashikuar në planin mësimor të këtij programi studimi.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumni ofron në mënyrë të vazhduar informacion dhe orientim të posaçëm në lidhje me tematika të mundësive për bursa studimi, mundësi për këshillim karriere apo ato të punësimit. Mundësitë për pjesëmarrje në projekte, konferenca apo programe exchange, por edhe të gjitha informacionet që u nevojiten studentëve për përmbushjen e programit të studimit, studentët mund ti aksesojnë në faqen zyrtare të USH</p> <p>Evidenca 5.10; Evidenca XLII; Evidenca 3.13</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë</p>	<p>Zyra e Alumnit dhe Karrierës në USH e cila mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe ka krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre, por që duhet të punohet më shumë, për të patur informacionin e duhur në lidhje me të punësuarit dhe për të qenë më afër tregut të punës.</p> <p>Këto të dhëna ajo i siguron bazuar në komunikimet e vazhdueshme me ta,</p>

ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	<p>nëpërmjet adresave të emailit, të dhënave të kontaktit, adresave të rrjeteve sociale, etj.</p> <p>Çdo vit, zyra e Alumnit dhe Karrierës, harton plane dhe raporte vjetore në lidhje me gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet, por në to ka mangësi për shifrat e sakta të punësimit.</p> <p>Në faqen zyrtare të universitetit nën seksionin student, studentët mund të aksesojnë në seksionin Alumni dhe të regjistrohen në bazën e të dhënave të kësaj zyre si edhe të plotësojnë pyetësorin e Alumni online.</p> <p>Evidenca 5.8</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<p>Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>FSHE në kuadër të zhvillimit dhe përmirësimit të metodave të ndryshme të mësimdhënies, bën analizën e punës mësimore e shkencore në të cilën evidentohen arritjet dhe problemet e vitit akademik objekt i analizës, të cilat kanë të bëjnë edhe me mësimdhënien.</p> <p>Gjithashtu në kuadër të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie, USH-ja mbështetet në strategjinë e mësimdhënies sipas së cilës për të realizuar qëllimet strategjike të mësimdhënies si edhe një mësimdhënie cilësore është e rëndësishme përdorimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies.</p> <p>USH-ja ndërmerr trajnime të vazhdueshme për stafin akademik që të implementojë metodat inovative në mësimdhënie dhe stafi akademik i USH-së angazhohet në projekte të ndryshme exchange që i shërbejnë përmirësimit të metodave të mësimdhënies apo implementimit të metodave të reja të mësimdhënies me të cilat pedagogët njihen gjatë këtyre trainimeve apo projekteve.</p> <p>Pjesë e këtyre projekteve kanë qënë edhe stafi akademik i Departamentit të</p>


	<p>Edukimit Fizik e Sporte. Gjatë vitit akademik 2021-2022 nga Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte janë angazhuar në projekte të ndryshme të shkëmbimit të eksperiencave me universitet të huaja, në funksion të përmirësimit të metodave në mësimdhënies, Dr. Fatjon Nurja, Dr. Nora Deda, Dr. Gjiuljo Zefi etj.</p> <p>Evidenca XVII; Evidenca IV; Evidenca 6.1; Evidenca 6.2</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Universiteti i Shkodrës në kuadër të vlerësimit të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmes akademik Senati Akademik ka miratuar paketën e instrumentave për matjen e cilësisë.</p> <p>Po në shërbim të vlerësimit të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit është edhe analiza e veprimtarisë mësimore dhe shkencore që bën FSHE çdo fundviti kalendarik.</p> <p>Në USH ushtron funksionin e saj Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë mbështetur mbi Statutin e USH-së ku ndër detyrat e saj janë hartimi i politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilat miratohen në Senatin Akademik, vlerësimi periodik i rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore, organizimi i pyetësorëve për cilësinë e mësimdhënies dhe lëndët e çdo programi studimi etj.</p> <p>Për të mbështetur NJSCB-në dhe procesin e vlerësimit të brendshëm, është ngritur edhe Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në USH</p> <p>Vlerësimi i performancës së stafit akademik si dhe analiza e punës mësimore janë përgjegjësi edhe e përgjegjësit të Departamentit të Edukimit Fizik e Sporte i cili paraqet me shkrim vlerësimet për performancën e pedagogëve si në rastin e pedagogëve të rinj.</p> <p>Evidenca XVI; Evidenca XVIII; Evidenca 2.10; Evidenca I, neni 24</p> <p>Evidenca 3.6; Evidenca XIV; Evidenca 6.3</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i raportit të GVB-së së programit të studimit konstatohet që Grupi i Vlerësimit të Brendshëm si edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë-në FSHE përfshijnë në strukturën e tyre studentë për vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies.</p> <p>Në GVB të Departamentit të Edukimit Fizik e Sporte përfaqësues i studentëve është studenti i vitit të III Albano Pjerëza ndërsa në NJSBC-në e FSHE-së përfaqësues të studentëve janë studentet Karmen Beci dhe Migena Beqiri.</p> <p>Evidenca B</p> <p>Evidenca 2.10</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse</p>	<p>Institucioni Universiteti i Shkodrës publikon rezultatet e vlerësimit të</p>

<p>për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>programit të studimit në mënyrë transparente duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Rezultatet e vlerësimit paraprake periodike, rezultatet, nga pyetësorët publikohen edhe ne faqen zyrtare të USH-së.</p> <p>Rezultatet e raportit të vlerësimit të brendshëm që sigurohen nga GVB-ja diskutohen në mbledhje departamenti dhe më pas miratohen dhe dërgohen për miratim ne dekanat. Pasi miratohen në Dekanat raportet kalojnë në Rektorat pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve.</p> <p>Në faqen zyrtare të universitetit publikohet gjithashtu edhe vendimi i ASCAL në lidhje me akreditimin institucional dhe të programeve të studimit.</p> <p>Evidenca 6.4 Evidenca 6.5</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ-ja konstaton gjatë ushtrimit të dokumentacionit të paraqitur se FSHE-ja realizon analizën e veprimtarisë mësimore dhe shkencore e cila i dërgohet Drejtorisë së Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve.</p> <p>Gjithashtu NJSBC-ja e FSHE-ja ushtron funksionin e saj në shërbim të garantimit dhe të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet mekanizmave të veta, siç janë pyetësorët sipas përcaktimeve të Statutit të Universitetit të Shkodrës.</p> <p>Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë në USH është në mbështetje të NJSBC-së së FSHE-së. Në USH është miratuar edhe paketa e instrumentave matës të cilësisë. Bazuar mbi rezultatet e marra nga mekanizmat e sipërpërmendura personeli akademik inkurajohet për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë duke reflektuar mbi pikat e forta të cilat i promovon dhe të dobëta që evidentohen dhe diskutohen në mbledhjet e departamentit për tu përmirësuar.</p> <p>Evidenca 3.6; Evidenca I, neni 24 Evidenca XVI; Evidenca 6.6</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>USH-ja ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale sipas ligjit të arsimit të lartë nr 80/15 si për nga organizimi ashtu edhe nga ndarja e detyrave të cilat janë të përshkruara në mënyrë të detajuar në statutin e institucionit, rregulloren e USH-së dhe në aktet e tjera rregullatore.</p> <p>Strukturat kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë komisioni i sigurimit të standardeve të cilësisë.</p> <p>Organizimi dhe funksionet e komisionit dhe njësisë janë të parashikuara në statutin e institucionit, Rregulloren e USH-së. Të dy këto struktura kanë aktet e tyre rregullatore, rregulloren e njësisë së zhvillimit kurrikular dhe sigurimit të cilësisë dhe rregulloren e komisionit të sigurimit të standardeve dhe cilësisë.</p> <p>Funksionimi i komisionit të vlerësimit të performancës ka në fokus jo vetëm performancën e stafit akademik proceseve akademike si proces kërkimor, vlerësimi i çështjeve studentore, vlerësimi i marrëdhënieve me komunitetin, por dhe vlerësimin e procesit të administrimit dhe zhvillimit institucional të vetë strukturave të USH-së. Komisioni i vlerësimit të performancës funksionon sipas rregulloreve të tij ku përcaktohen mënyra e funksionimit, parimet dhe fusha e veprimtarisë.</p> <p>USH-ja ka të mirëorganizuar strukturat dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Një strukturë e ngritur në funksion të garantimit të cilësisë është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e mbështetur në Statutin e USH-së ku ndër detyrat e saj janë hartimi i politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilat miratohen në Senatin Akademik.</p> <p>Për të mbështetur NJSCB-në dhe procesin e vlerësimit të brendshëm, është ngritur edhe komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në USH i cili ushtron funksionin e tij mbi bazën e Rregulloreve të Komisionit për garantimin e standardeve të cilësisë në USH. Gjithashtu është miratuar Paketa e instrumentave matës të cilësisë në USH. Strukturat, politikat dhe procedurat e ndjekura në USH për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</p>




	<p>mbështeten mbi standardet e përcaktuara në Manualin e Cilësisë.</p> <p>Evidenca 2.10; Evidenca I, neni 24; Evidenca 3.6</p> <p>Evidenca XIV; Evidenca XV; Evidenca XVI; Evidenca X</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka të ngritur Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët, bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Përveç strukturave të përmendura më lart janë edhe një sërë mekanizmesh e strukturash që ndërthuren për të përmbushur të gjithë strategjinë e USH-së në sigurimin e cilësisë.</p> <p>Në USH në përbërje të NJSBC-së janë dy studentë edhe ekspertë të jashtëm. Në nivel të njësisë kryesore ngrihet GVB-ja e Departamentit në funksion të sigurimit të standardeve të cilësisë për programin e studimit. Strukturat, politikat dhe procedurat e ndjekura në USH për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë mbështeten mbi standardet e përcaktuara në Manualin e Cilësisë.</p> <p>Evidenca 2.10; Evidenca B; Evidenca X</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, USH-ja i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues institucional të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Raportet e vlerësimit të brendshëm realizohen nga GVB-ja dhe gjenden në intranet, qarkullohen nëpërmjet mailit dhe publikohen në faqen Eëb-in e USH-së.</p> <p>Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, me GVJ-në në bashkëpunim me vlerësimet analitike e krahasuese, si dhe me procese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p> <p>Vlerësimi i jashtëm menaxhohet nga ASCAL-i. Sigurimi i jashtëm i cilësisë bazohet në raportet e vetëvlerësimit dhe gjithmonë ka rol edukues duke vëzhguar me kujdes gjëndjen aktuale dhe duke dhënë rekomandime për përmirësim të metejshme në kuadër të përmbushjes së standardeve të cilësisë. Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 17.09.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit”, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin periodik institucional ka vendosur për USH-në me vendim nr.70, datë 21.09.2017, një akreditim 2 vjeçar me 8 rekomandime përkatëse. Ndërsa në akreditimin e dytë BA-ja vendosi të akreditojë USH-në sipas</p>

	<p>vendimit nr. 03, datë 24.01.2020 për 4 vite akademike deri më 23/01/2024 me 5 rekomandime përkatëse.</p> <p>Me këtë akreditim është hera e parë që aplikohet për akreditim e programeve të studimit të FSHE-së, si rrjedhojë nuk disponohen raporte të vlerësimit të jashtëm. Megjithatë vlerësimet e brendshme, analitike apo krahasuese në njësisë bazë që mbulon këtë program studimi kryhen në mënyrë periodike siç janë analizat vjetore të cilat kryhen për të përmirësuar cilësinë dhe korrigjuar mangësitë.</p> <p>Evidenca 3.5</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>USH-ja ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve. Kjo e shprehur në strategjinë e zhvillimit të institucionit 2020/2030.</p> <p>Rregullorja e komisionit të sigurimit të standardeve të cilësisë, rregullorja e njësisë së zhvillimit kurrikular dhe cilësisë, manuali i mësimdhënies online udhëzuesi për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit, manuali i hartimit të kurrikulave etj, janë vetëm disa nga dokumentet që janë hartuar për garantimin e cilësisë.</p> <p>Referuar Manualit të Cilësisë në USH në nenin 1 të këtij manuali përcaktohen objektivat e tij. Ndër të tjera Manuali ka si objekt të përcaktojë organizimin dhe funksionimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë si edhe procedurat e metodat për sigurimin e cilësisë në nivel institucional.</p> <p>Për të siguruar një paqyrë sa më të qartë mbi arritjet dhe dobësitë në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin institucioni ka miratuar Paketën e instrumentave matës të cilësisë në USH dhe NJSBC e fakultetit dhe GVB-së në nivel njësie bazë aplikojnë pyëtorët të cilët përmbajnë tregues të qartë dhe të matshëm. Mbi bazën e këtyre treguesve institucioni reflekton mbi arritjet dhe dobësitë e evidentuara dhe nxitet për arritje më të larta.</p> <p>Evidenca X; Evidenca 2.10; Evidenca B; Evidenca 3.5</p> <p>Evidenca 3.6; Evidenca XVI</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rishikimi i programeve të studimit fillon nga njësia bazë dhe ndihmohet nga njësia e zhvillimit kurrikular dhe cilësisë. Zv. rektori për problemet mësimore bashkërendon punën e tyre për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen e rishikimin e programeve të studimit.</p> <p>NJSBC-ja e FSHE-së bazuar edhe në detyrat që ia përcakton Rregullorja e FSHE vlerëson periodikisht verprimitarinë mësimore dhe kërkimore shkencore në FSHE si edhe cilësinë e programeve të studimit që ofron FSHE. Gjithshtu kjo njësi prezanton raportin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë së FSHE-së për miratim në dekanat e më pas në Rektorat.</p> <p>Në këtë proces përveçse evidentohen pikat e forta dhe të dobëta, sugjerohen edhe mundësitë apo masat për përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit.</p> <p>Evidenca 1.2, neni 13; Evidenca 2.10; Evidenca 3.5 Evidenca 3.6; Evidenca 6.5</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve vendimmarrëse në disa menyra. Nga njësia e zhvillimit kurrikular dhe cilësisë ka një raportim në nivel institucional për procese të ndryshme monitorimi, në lidhje me programet dhe me gjithë problematikat e tjera. Ndërkohë edhe nga departamenti bëhen raportime lidhur me ecurinë e procesit në strukturat dhe autoritetet akademike e administrative.</p> <p>NJSBC-ja harton raportin e vlerësimit të brendshëm i cili përmban rezultatet e vlerësimit, pikat e forta dhe të dobëta si edhe mundësitë që ndikojnë në përmirësimin në vijimësi të cilësisë.</p> <p>Gjithashtu në nivel të njësive bazë, GVB-jabën vlerësimin e brendshëm të cilësisë për programet e studimit që ofron, harton raportet e vlerësimit të brendshëm të cilat përmbajnë rezultatet e vlerësimit, pikat e forta e të dobëta dhe syzjerimet për përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit që ofron. Ky raport vlerësimi diskutohet miratohet në departament dhe në dekanat.</p>



	<p>Evidenca B</p> <p>Evidenca 6.3</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në USH ekzistojnë një sërë procedurash e mekanizmash, formate të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas herë të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p> <p>Njësitë bazë që ofrojnë programin e studimit kanë në dorë riorganizimin e tyre të plotë ose në masën 20%. Përgatitja për hapjen e programeve të reja bëhet në përputhje me strategjinë afatgjatë e afatmesme të USH-së dhe në përputhje të plotë me kërkesat ligjore në fuqi. USH-ja nëpërmjet njësive të saj ka përgatitur udhëzues e manuale me qëllim orientimin e punës së njësive bazë për hapjen e programeve të studimit dhe hapave që duhet të ndjekin.</p> <p>USH-ja, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si dëgjime në auditor apo rezultatet e arritura nga studentet në provimet, testimet apo praktika pedagogjike. Nëpërmjet instrumentit të pyetësorit të realizuar me studentët, organizuar në seksione të caktuara, merret informacion në lidhje me aspekte të rëndësishme të cilësisë së mësimdhënies si (leksionet, seminarët, niveli i përgatitjes së pedagogëve etj.</p> <p>Analiza e punës mësimore dhe shkencore në FSHE, është një tjetër dokument nga ku sigurohet drejtpërdrejtë informacion mbi cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>Evidenca 3.5; Evidenca 3.6; Evidenca XVII</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për</p>	<p>Universiteti i Shkodrës, njësia kryesore dhe ajo bazë në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdorin metoda e instrumente të tërthorta e të drejtpërdrejta vlerësimi që janë si më poshtë:</p> <p>Metodat e tërthorta të vlerësimit janë aplikuar përmes pyetësorëve për marrjen e informacioneve vlerësuese nga studentët e diplomuar mbi kategori si: a. Profesionalizmi i pedagogut të lëndës; b. Përmbajtja e lëndës; c. Sugjerimet nga studentët.</p> <p>Metodat e drejtpërdrejta janë: a. Vlerësimi me notë dhe pikë; b. Vlerësim i detyrave të kryera nga studentët; c. Vlerësimi me pikë i aktivizimit të studentit në auditor; d. Vlerësimi dhe ndjekja e vazhdueshme gjatë praktikës në institucione.</p> <p>Për të shmangur konfliktin e interesit, të dhënat e pyetësorit të studentëve menaxhohen nga Zyra e Sigurimit të cilësisë dhe e vlerësimit të standardeve.</p>

vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Evidenca 3.5			
	Evidenca 3.6			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Institucioni garanton përfshirje të aktorëve të brendshëm dhe jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Në komisionin e sigurimit të brendshëm të cilësisë është parashikuar që të ketë edhe një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve.</p> <p>USH-ja ka hartuar politika dhe ka ngritur struktura dhe procedura për sigurimin e Brendshëm të Cilësisë siç përcaktohet në Statutin e USH-së të cilët ngrihen në rang universiteti dhe në njësitë kryesore.</p> <p>Në funksion të këtij qëllimi është ngritur Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit i cili e mbështet funksionin e vet mbi Rregulloren e Komisionit për garantimin e standardeve të cilësisë në USH.</p> <p>Gjithashtu është miratuar nga Senati Akademik paketa e instrumentave matës të cilësisë në USH si dhe është ngritur NjSBC-ja e FSHE-së, e cila është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë. Organizimi dhe funksionim i mekanizmave të sigurimit të cilësisë dhe procedurave e metodave të sigurimit të cilësisë në nivel institucional mbështetet në Manualin e Cilësisë në USH.</p> <p>Evidenca I, neni 23, Dosja I; Evidenca XIV; Evidenca XV</p> <p>Evidenca XVI; Evidenca 2.10; Evidenca X.</p>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe	<p>Anëtarët përbërës të Komisionit të sigurimit të Cilësisë, njësisë së zhvillimit kurrikular dhe cilësisë, kanë përgjegjësi dhe detyra konkrete dhe të ndryshme, në përshtatje edhe me rolet që ata kanë.</p> <p>Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte për sigurimin e brendshëm të cilësisë ngre grupin e vlerësimit të brendshëm me detyra specifike secili anëtar, duke përfshirë në të një ekspert të jashtëm dhe një student.</p>

<p>garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Grupi bashkërendon detyrat dhe kryetari i grupit monitoron punën e grupit të vlerësimit të brendshëm dhe është në komunikim të vazhdueshëm me Zv Dekanen dhe me zyrën në rektorat. Po ashtu NJSBC-ja aktuale është ristrukturuar me vendim të datës 29.10.2020 në mbledhjen e Dekanatit të FSHE-së</p> <p>Secili Departamenti ka një përfaqësues në këtë njësi. Studentët që i bashkohen Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë zgjidhen ndër studentët më të impenuar dhe aktivë të programit dhe mbeten pjesë e grupit të vlerësimit deri në përfundim të realizimit të raportit të vlerësimit.</p> <p>Evidenca B; Evidenca 2.10</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Në vlerësimin e sigurimit të cilësisë së programit të studimit garantohet përfshirja e personelit nga njësia bazë, anëtarë të personelit akademik, stafit ndihmës administrativ dhe studentëve. Anëtarët e grupit të vlerësimit të brendshëm për programin e studimit janë pedagogë në njësinë bazë ose kryesore që ofron programin.</p> <p>Vetë metodologjia e hartimit të RVsë e përshkruar në hyrje të këtij raporti tregon përfshirjen e të gjithë aktorëve në këtë proces. Komunikimi ruhet nëpërmjet emai-it dhe i gjithë procesi është transparent për njësinë bazë dhe kryesore.</p> <p>Në funksion të sigurimit të cilësisë së programit të studimit, nëpërmjet akteve rregullatore që përcaktojnë përbërjen e strukturave të posaçme për vlerësimin garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore si dhe anëtarëve të personelit akademik dhe studentëve.</p> <p>Evidenca 2.10; Evidenca B</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit është në përputhje me Kodin e Etikës dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve.</p> <p>Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm bëhet në një mbledhje të njësisë bazë gjatë së cilës të pranishmit në mbledhje bien dakort për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm duke bërë përpjekje që secili nga aktorët të luajë rolin e vet në proceset e vlerësimit duke shmangur diskriminimin apo pabarazinë kundrejt personelit.</p> <p>GVB-ja; Evidenca B</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë</p>	<p>Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm e të jashtëm në proceset ciklike të vlerësimit është në përputhje me Kodin e Etikës dhe bëhen përpjekje për të shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie, edhe për bashkëpunëtorët e jashtëm.</p>


dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. (Evidenca B).		
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht
			X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Institucioni USH harton politika, strategji e organizim të veprimtarive të Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë në mënyrë transparente nga një komision i emëruar nga Rektori dhe i miratuar nga Senati me afat kohor dy vjet. Në çdo fillim viti harton planin dhe në fund të vitit raporton vlerësimet për aritjet, të cilat publikohen edhe në faqen e ëebstitit dhe të zyrës së performancës. Programet publikohen edhe në ambjentet e universitetit.</p> <p>USH-ja në kuadër të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësië zbaton një strategji që fillon me ngritjen Komisionit për Garantimin e Cilësisë i cili e mbështet veprimtarinë e tij në Manualin e Cilësisë hartuar sipas Kodit të Cilësisë së Arsimit të lartë dhe në aktet e tjera ligjore në fuqi.</p> <p>Ky Manual është transparent për studentët dhe të interesuarit pasi është i publikuar në faqen zyrtare të USH-së. Gjithashtu në faqen zyrtare të USH është e publikuar edhe Paketa e Instrumentave për matjen e Cilësisë e aksesueshme për të intresuarit.</p> <p>Po në funksion të transparencës, në faqen zyrtare të USH postohen edhe raportet e vlerësimit të brendshëm, sic është raporti i vetë vlerësimit i vitit 2021-2022. Në nivel të Njësisë Bazë dhe të Njësisë Kryesore politikat janë gjithashtu transparente. Grupet e Vlerësimit të Brendshëm ngrihen në mënyrë transparente me mbledhje të veçanta. Miratohen fillimisht në Departament dhe më pas në Dekanat.</p> <p>Evidenca XIV; Evidenca X</p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të	Institucioni USH publikon rezultatet e vlerësimit të programit të studimit në

<p>lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>mënyrë transparente duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit paraprake periodike, rezultatet e pyetësorëve publikohen edhe në faqen e website.</p> <p>Ky program studimi akreditohet për herë të parë, megjithatë institucioni bën publike vendimet mbi akreditimin periodik intstitucional të USH-së duke respektuar lirinë dhe etikën akademike dhe duke mbrojtur elementet e privatësisë dhe anonimatit e subjekteve të përfshira në procesin e vlerësimit.</p> <p>(Evidenca 6.5)</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Përfundimet e dala nga vlerësimi që bëhet në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, ku evidentohen pikat e forta dhe të dobëta, si dhe detyrat e lëna nga grupi i vlerësimit të jashtëm caktuar nga ASCAL, bëjnë që strukturat e universitetit të angazhohen për korrigjimin dhe përmirësimin e mangësive të shkruara në RVJ.</p> <p>Në përmbyllje të raportit të vetëlerësimit, grupi i vlerësimit të brendshëm evidenton pikat e forta dhe të dobëta të raportit të vlerësimit. Mbi bazën e këtyre pikave bëhen edhe rekomandimet në funksion të përmirësimin të dobësive të gjetura. Njësia bazë angazhohet që të përmirësojë rezultatet në ato pika që raporti (RVB) ka paraqitur mangësi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Përmirësimi i vazhdueshëm i programeve bëhet mbi bazën e detyrave të lëna nga grupet e vlerësimit të cilësisë nëpërmjet, pasurimit, plotësimit të materialeve të temave mësimore, pasurimit të literaturës bazë dhe asaj të rekomanduar etj. Ndryshimet profilizuese të programit të studimit bëhen deri në masën 20% sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi. Ndryshimet mbi 20% kërkojnë riakreditim të programit të studimit.</p> <p>Departamenti i Edukimit Fizik e Sporte vlerësojnë dhe sigurojnë efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Nëpërmjet këtij raporti vlerësimi sigurohet informacion në lidhje me efektivitetin e programit të studimit në Edukim Fizik e Sporte.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e</p>	<p>Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë organizon veprimtari periodike me personelin dhe me studentët për informimin ndërgjegjësimin dhe trajnimin e tyre. Në vitin akademik 2019-2022 kjo veprimtari u krye edhe online në përshtatje me situatën e krijuar nga COVID -19. Përmirësimi</p>

<p>tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>afatgjatë i cilësisë së programit të studimit është e shprehur dhe në planin strategjik të programit të studimit.</p> <p>Në takimet e caktuara me studentët diskutohen edhe çështje në lidhje me rolin e tyre në procesin e sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë së programit të studimit. Gjithashtu edhe vetë pedagogët vazhdimisht informojnë studentët për përfshirjen e tyre në proceset e sigurimit të cilësisë së programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Plotësisht përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Edukim Fizik e Sporte”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i Studimit Cikli i Parë Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte” është një program i strukturuar, bashkëkohor dhe shume atraktiv për mundësitë që jepen për punësim nga tregu i punës.
2. Prezenca e një stafi 100% të kualifikuar si nga ana profesionale shkencore, ashtu edhe nga historiku i tyre si kampionë në sportet respektive, përbën një pasuri dhe një element i fortë marketingu për këtë program studimi.
3. Zgjerimi i hapësirës infrastrukture dhe paisja me teknologji informimi moderne e bashkëkohore ndikon drejtpërsëdrejti në mbarëvajtjen e procesit të studimit dhe i bën studentet komodë në arritjen e objektivave të tyre afatshkurtëra e afatgjata.
4. Shoqata Sportive Studentore e Universitetit të Shkodrës, e drejtuar dhe udhëhequr nga pedagogët e njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, e mbështetur pa rezerva edhe financiarisht nga dekanati dhe rektorati, është një vlerë e shtuar në përfaqësimin dinjitoz të universitetit në rang kombëtar dhe ndërkombëtar.

Pika të dobëta:

1. Veprimtaritë shkencore janë të shumta në rang universiteti, por mungon një plan i programuar nga departamenti për punën shkencore, referimet dhe botimet e stafit akademik.
2. Nivel jo i kënaqshëm i përfshirjes së studentëve në kërkimin shkencor dhe numër i vogël projektsh kërkimore në rang njësie bazë.
3. Mobilitet i ulët i stafit akademik dhe sidomos i studentëve në programin Erasmus + etj.
4. Literatura kryesisht e huaj në bibliotekë është e pa përditësuar dhe ka nevojë emergjente për shtimin e fondit të titujve me leading books kryesisht nga Human Kinetics në fushat e sportit kompetitiv dhe aktivitetit fizik për shëndet.



Rekomandime:

1. Angazhim më i madh si për stafin akademik të njësisë bazë ashtu edhe i studentëve në kërkimin shkencor dhe në projektet kërkimore.
2. Njësia bazë minimumi 1 herë në vit të organizojë workshop mbi të rejat në fushën e sportit me pjesëmarrjen me referime apo poster edhe të studentëve dhe 1 herë në dy vjet të organizojë konferencën e saj në rang IAL-je.
3. Duhet bërë përpjekje më të mëdha për të rritur mobilitetin si të stafit akademik ashtu edhe të studentëve të programit të studimit sidomos në kuadër të ndërkombëtarizimit të IAL-ve.
4. Duhet bërë përpjekje më të mëdha në drejtim të gjurmimit të studentëve mbas diplomimit dhe këto të pasqyrohen e mblidhen në një database të dedikuar.
5. Zyra e financës dhe Administratori i USH-së të përcaktojnë një fond të dedikuar për çdo program studimi kryesisht për blerje literature dhe mjete e paisje didaktike e mësimore.
6. Të rishikohen të gjitha Syllabet dhe CV-të sipas standarteve dhe udhëzimeve më të fundit nga MAS.

The evaluation of the first cycle of the bachelor's degree program in "Physical Education and Sports" has reached its conclusions.

Affirmations and Strengths:

1. The "Physical Education and Sports" First Cycle Bachelor's Study Program is an organized, modern, and very alluring program for the employment chances presented by the labor market.
2. Having a staff that is completely competent in both professional and scientific terms, as well as from their past accomplishments as champions in their respective sports, is a plus and a powerful marketing tool for this study program.
3. Increasing the infrastructure and providing it with cutting-edge technology has a direct impact on how well the learning process is going and gives students the confidence to accomplish their short- and long-term goals.


4. The Student Sports Association of the University of Shkodra, which is run and funded unconditionally by the dean's office and the rector's office, is an asset to the respectable representation of the university at the national and international levels. It is directed and led by the lecturers of the basic unit in charge of this study program.

Poor points

1. Although there are many scientific activities occurring at the university level, the department does not have a program in place to support the research, references, and publications of the academic staff.
2. There aren't enough students participating in scientific research, and there aren't many research initiatives at the basic unit level.
3. Limited movement of academic staff, particularly Erasmus+ students, etc.
4. The library's mostly foreign collection of books has to be updated, and there is a pressing need to include more popular titles primarily from Human Kinetics—in the fields of competitive sports and physical activity for health.

Recommendations:

1. Increased participation of students and academic personnel from the core unit in research and research projects.
2. The basic unit hosts a workshop on young women in sports at least once a year, inviting students to participate with references or posters, and once every two years, it has its conference at the HEI level.
3. More work needs to be done to improve the mobility of the academic staff as well as the program's students, particularly in light of the globalization of HEIs.
4. There should be more effort put into tracking students after they graduate, and this information should be recorded and gathered in a specific database.
5. The Finance Office and the USH Administrator will choose a special fund for each study program, which will be used mostly to buy books and other educational materials.
6. To update all curriculum vitae and syllabuses in accordance with MAS guidelines and the most recent standards.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

